



Ministri Peleshi: Mirënjohje aleancës dhe partneritetit të besueshëm që SHBA ka për Shqipërinë

4 Korriku, i njohur si Dita e Pavarësisë, është dita kur në vitin 1776 delegatët nga 13 kolonitë e Shteteve të Bashkuara miratuan Deklaratën e Pavarësisë, duke njoftuar shkëputjen nga Britania. Kjo ditë është festë federale në Shtetet e Bashkuara që nga viti 1941 dhe tradicionalisht është një ditë kur amerikanët festojnë me fishekzjarrë, parada, koncerte dhe piknikë. Shtetet e Bashkuara janë aleati strategjik i Shqipërisë, që vitet e fundit e kanë forcuar edhe më shumë marrë-

dhënien me Shqipërinë dhe shqiptarët. Falë mbështetjes amerikane, Shqipëria drejtoi Këshillin e Sigurimit dhe është anëtare e përkohshme për dy vite e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Shqipëria mirëpriti për të dytin vit radhazi 'Defender 21 dhe 23', stërvitje të NATO-s nga më të mëdhatë në vitet e fundit, ku mijëra trupa amerikane erdhën në tokën shqiptare për të treguar forcën e aleancës më të madhe ushtarake në botë. Amerikanët kanë qenë prezent edhe në

zhvillimet politike të viteve të fundit, duke na dhënë mbështetje të pakushtëzuar, rezultati: Shqipëria dhe shqiptarët dekadat e fundit janë bërë faktor i rëndësishëm në Ballkan. Kjo marrëdhënie e ngushtë është vënë re me vizitat e presidentëve amerikane në Shqipëri, i pari President i Shteteve të Bashkuara të Amerikës që ka vizituar Shqipërinë është Jimmy Carter, i dyti, presidenti i 41-të i Shteteve të Bashkuara, George Herbert Walker Bush... » faqe 3



Prezantohen rezultatet e monitorimit të satelitëve "Albania 1" dhe "Albania 2"



Efektivët e FARSH dhe anija "Butrinti P-134" nisen në misionin e NATO-s "Sea Guardian", në detin Egje

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Arben Kingji mori pjesë në ceremoninë e përcjelljes së efektivëve të FARSH dhe Anijes "Butrinti P-134", në operacionin e NATO-s "Sea Guardian", në Detin Egje. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, e cila u zhvillua në Flotiljen Detare Pashaliman ishin gjithashtu të pranishëm komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, komandantë forcash, përfaqësues të pushtetit lokal, drejtorë drejtorie në SHP, përfaqësues ushtarakë të Republikës së Turqisë, familjarë, etj. Në...



Faqe 2

Batalioni i Xhenios në rrugëtimin e tij mes arritjesh dhe sfidash

Kolonel Shkëlzen Mhillaj, komandant i Batalionit të Xhenios, me një formim dhe karrierë të pasur ushtarake, vjen për lexuesin tonë nëpërmjet kësaj interviste, për të sjellë një pjesë të aktivitetit të Batalionit të Xhenios, si një prej institucioneve elitare të Forcave të Armatosura. Kolonel Shkëlzen Mhillaj, ka ushtruar detyra të ndryshme përgjatë ushtrimit të detyrës në uniformën ushtarake, si: Komandant i Qendrës Menaxhimit të Materialeve; Përgjegjës Shtabi në QBO; Komandant i Qendrës Stërvitore të KM-së; Shef Degës Planifikimit në Komandën Mbështetëse; Oficer Shtabi...



Faqe 6

80 vjet nga krijimi i Shtabit të Përgjithshëm

10 Korriku 1943, data e krijimit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, e vendosur, nga qeveria e pasluftës, në kalendarin e festave shtetërore të Shqipërisë si festë e ushtrisë, është hequr si e tillë, nga qeveria e pas vitit 1991, duke qenë që ky shtab nuk ishte i pari shtab i përgjithshëm i ushtrisë së Shqipërisë. Në respekt historik dhe institucional, qeveria e pas vitit 1991, vendosi që festë e ushtrisë të jetë data 4 Dhjetor, dita që qeveria e shtetit të sapo themeluar shqiptar krijoi Ministrinë e Luftës. Ajo qeveri, më 4 maj 1913 ngriti edhe...



Faqe 10



Efektivët e FARSH dhe anija “Butrinti P-134” nisen në misionin e NATO-s “Sea Guardian”, në detin Egje

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Arben Kingji mori pjesë në ceremoninë e përcjelljes së efektivëve të FARSH dhe Anijes “Butrinti P-134”, në operacionin e NATO-s “Sea Guardian”, në Detin Egje. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, e cila u zhvillua në Flotiljen Detare Pashaliman ishin gjithashtu të pranishëm komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, komandantë forcash, përfaqësues të pushtetit lokal, drejtorë drejtorie në SHP, përfaqësues ushtarakë të Republikës së Turqisë, familjarë, etj.

Në përshëndetjen e tij drejtuar efektivëve që do nisen në misionin e NATO-s, gjeneralmajor Kingji, pasi falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen, vlerësoi efektivët ushtarakë në FARSH, që kanë shërbyer dhe shërbejnë në misione të shumta jashtë vendit, të cilët me profesionalizmin e tyre kanë fituar respektin



dhe besimin e partnerëve dhe aleatëve.

“Angazhimet në misionet dhe operacionet jashtë vendit tashmë janë bërë detyra të zakonshme për Forcat tona të Armatosura. Efektivët tanë që kanë shërbyer dhe shërbejnë në misione të shumta jashtë vendit, kanë treguar profesionalizëm, duke fituar respektin dhe besimin e partnerëve dhe aleatëve. Ky vlerësim, pa dyshim që na bën të ndihemi krenarë, por gjithashtu na vendos përpara përgjegjësisë akoma edhe më të mëdha, për të vepruar në

mjedise gjithnjë e më komplekse dhe të paparashikueshme. Ndaj na takon ne, që të punojmë përshtetshëm për zhvillimin e pandërprerë të Forcave tona të Armatosura”, - u shpreh ndër të tjera gjeneralmajor Kingji. SHSHPFA gjeneralmajor Arben Kingji ka përmbyllur përshëndetjen e tij, duke adresuar një falënderim dhe mirënjohje të veçantë për familjet e efektivëve detarë që nisen me mision, si dhe u ka uruar efektivëve suksese në këtë operacion të rëndësishëm dhe lundrim të mbarë.

Kremtohet 55-vjetori i krijimit të Batalionit të Xhenios

Në ambientet e Batalionit të Xhenios në një atmosferë festive u zhvillua ceremonia e kremtimit të 55-vjetorit të krijimit të këtij batalioni. Në këtë ceremoni ishin të pranishëm komandanti Komandës Mbështetëse gjeneral brigade Ferdinant Dimo, komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, xhenierë efektiv të batalionit ndër vite si të ftuar të tjerë.

Fjalën e hapjes e mbajti komandanti i Batalionit të Xhenios, kolonel Shkëlzen Mhillaj, i cili pasi falënderoi pjesëmarrësit u ndal në punën e palodhur, përkushtimin, profesionalizmin e xhenierëve ndër vite dhe deri në ditët e sotme, ku puna e dora e tyre ndihet kudo në vend. Më pas fjalën e mbajti komandanti i parë i batalionit Xheniero-Ndërtues, Abil Zerani, i cili foli mbi rëndësinë e këtij batalioni që nga krijimi i tij, detyrat e veçanta dhe evoluimin ndër vite. Komandanti i KM, gjeneral brigade Ferdinant Dimo, në fjalën e tij përshëndetëse kujtoi punën



dhe vetëmohimin e xhenierëve ndër vite, angazhimin e tyre në rritjen e sigurisë në vend si eliminimin e minave të paplasura, ndërtimin e urave, prishjen e masiveve shkëmbore etj. Ai përmendi dhe efektivat EOD në misionin e Prezencës së Përpunuar të Përfortuar të NATO-s, në Letoni si dhe u ndal në vëmendjen që ka Ministria e Mbrojtjes dhe Komanda Mbështetëse në veçanti për modernizimin e këtij batalioni, kompanisë EOD, si aset i Forcave të Armatosura shqiptare. Në fund të ceremonisë u bë një foto e përbashkët.



Gjeneral brigade Bilbil Bitri priti atasheun ushtarak të SHBA-së, kapiten i rangut I David Millner

Komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura (AFA) gjeneral brigade Bilbil Bitri zhvilloi një takim me atashen ushtarak të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kapiten i rangut I David Millner, në kuadër të bashkëpunimit ushtarak dypalësh dhe përfundimit të mandatit të atashut ushtarak rezident në Tiranë.

Gjeneral Bitri vlerësoi bashkëpunimin e deritanishëm midis dy palëve për transformimin e AFA-së sipas modelit të Akademisë Ushtarake Amerikane “West Point”, ndërsa atashen ushtarak amerikan falënderoi gjeneral Bitrin për lidhshirësin e treguar në këtë proces dhe arritjet që AFA ka bërë në këtë drejtim.



Gjatë takimit u prezantua edhe atashen i ri ushtarak i SHBA-së, kapiten i rangut I Eric Cotë. Gjeneral Bitri i uroi mirëseardhjen atashut të ri të SHBA-së dhe e siguroi atë për mbështetjen dhe vijimin e projekteve të bashkëpunimit ushtarak midis Akademive të të dy vendeve, duke filluar me angazhimin konkret për hapjen e brezit të parë sipas modelit “West Point” në tetor të këtij viti.



QAPU zhvilloi ceremoninë e Certifikimit dhe Betimit të rekrutëve

Në mjediset e Qendrës së Arsimit Profesional të Ushtarëve, Vlorë, dhe batalionin e Parë dhe të Tretë të këmbësorisë, u zhvillua ceremonia e Certifikimit dhe Betimit të rekrutëve, të cilët përfunduan kursin e Stërvitjes Individuale Bazë. Në përfundim të këtij kursi u certifikuan 74 rekrutë, të rinj e të reja, nga mbarë vendi, të cilët tashmë janë pjesë e Forcave tona të Armatosura.



Ministri Peleshi: Mirënjohje për aleancën e pandërprerë dhe partneritetin e besueshëm që Shtetet e Bashkuara kanë për Shqipërinë

4 Korriku, i njohur si Dita e Pavarësisë, është dita kur në vitin 1776 delegatët nga 13 kolonitë e Shteteve të Bashkuara miratuan Deklaratën e Pavarësisë, duke njoftuar shkëputjen nga Britania.

Kjo ditë është festë federale në Shtetet e Bashkuara që nga viti 1941 dhe tradicionalisht është një ditë kur amerikanët festojnë me fishekzjarrë, parada, koncerte dhe piknikë.

Shtetet e Bashkuara janë aleati strategjik i Shqipërisë, që vitet e fundit e kanë forcuar edhe më shumë marrëdhënien me Shqipërinë dhe shqiptarët.

Falë mbështetjes amerikane, Shqipëria drejtoi Këshillin e Sigurimit dhe është anëtare e përkohshme për dy vite e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Shqipëria mirëpriti për të dytin vit radhazi 'Defender 21 dhe 23', stërvitje e NATO-s nga më të mëdhatë në vitet e fundit, ku mijëra

trupa amerikane erdhën në tokën shqiptare për të treguar forcën e aleancës me të madhe ushtarake në botë.

Amerikanët kanë qenë prezent edhe në zhvillimet politike të viteve të fundit, duke na dhënë mbështetje të pakushtëzuar, rezultati: Shqipëria dhe shqiptarët dekadat e fundit janë bërë faktor i rëndësishëm në Ballkan.

Kjo marrëdhënie e ngushtë është vënë re me vizitat e presidentëve amerikanë në Shqipëri, i pari President i Shteteve të Bashkuara të Amerikës që ka vizituar Shqipërinë është Jimmy Carter,

I dyti, presidenti i 41-të i Shteteve të Bashkuara, George Herbert Walker Bush, së bashku me ish-Sekretarin Amerikan të Shtetit, Colin Powell.

Më 10 qershor të vitit 2007 Shqipërinë e vizitoi presidenti Xhorxh W. Bush, vizita më e rëndësishme në 3 dekada, jo vetëm sepse Bush ishte i vetmi president në detyrë që ka vizituar Shqipërinë, por edhe sepse nga Tirana, Shtetet e Bashkuara bënë të qartë mbështetjen për

pavarësinë e Kosovës.

Kremtimet e Pavarësisë së shtetit amerikan do të kishin një domethënie të madhe sepse në Shqipëri në këtë prag feste do të vinte presidenti i 42-të amerikan, Bill Clinton, i cili gjatë mandatit të tij si president i shtetit më të fortë në botë ndikoi në miratimin dhe realizimin e vendimeve të OKB-së për ndërhyrjen e NATO-së në Luftën e Kosovës në vitin 1999, çka detyroi presidentin e atëhershëm të asaj që kishte mbetur nga Jugosllavia, Slobodan Millosheviç, të pranonte kushtet e një marrëveshjeje për t'i dhënë fund fushatës së tij ushtarake kundër UÇK-së. Ish-presidenti Clinton u prit nga kryeministri i vendit z. Edi Rama, kabineti qeveritar dhe populli shqiptar në shesh për të shprehur respektin dhe mirënjohjen e pakufi për mbështetjen që ky njeri i madh i dha popullit kosovar në momentet më të vështira të tij. Mes shumë urimesh drejtuar popullit amerikan do të ishte dhe ajo e Ministrit të Mbrojtjes Niko



Peleshi: Kështu që 4 korriku është ditë feste edhe për Shqipërinë dhe shqiptarët. Mirënjohje për aleancën e pandërprerë dhe partneritetin e besueshëm që Shtetet e Bashkuara kanë për Shqipërinë. Përvoja e SHBA-së në mbështetjen e

demokracisë, lirisë dhe të drejtave të njeriut është një frymëzim për të gjithë ne.

Krenarë që kemi një partner të fortë në rrugën drejt progresit. Gëzuar 4 Korrikun!

Prezantohen rezultatet e monitorimit të satelitëve "Albania 1" dhe "Albania 2"

Në aktivitetin, ku morën pjesë kryeministri Edi Rama, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, drejtues të institucioneve të ndryshme dhe ekspertë, u prezantuan produktet e para të shërbimit satelitor.

Zëvendëskryeministrja Belinda Balluku tha se Shqipëria ka arritur të monitorojë përmes dy satelitëve të lëshuar në hapësirë, "Albania 1" dhe "Albania 2", 47% të territorit.

"Me një gamë të gjerë përdorimi, nga parandalimi i zjarreve të përmytjet, duke vijuar te bujqësia dhe ndërtimi pa leje, Shqipëria përmes satelitëve të hedhur në hapësirë, "Albania 1" dhe "Albania 2", - sipas zëvendëskryeminstres Belinda Balluku, - bëhet pjesë e ekonomisë së re të hapësirës, duke zhvilluar përfshirjen e saj në komunitetin hapësinor, mes shfrytëzimit të fuqisë së imazheve satelitore me rezolucion të lartë, të cilat mundësojnë realizimin e ambicieve tona si vend anëtar i NATO-s".

Kryeministri Edi Rama u shpreh se falë shërbimit satelitor kemi një bazë fantastike të leximit të territorit sipas nevojave të dikastereve, gjë që e bën të pamundur korrupsionin në shumë fusha: "Deri më 21 qershor janë mbledhur të dhëna nga 16.324 km2 të Republikës së Shqipërisë. Për shkak se moti e vështirësoi shumë punën e atyre që janë përfshirë në këtë proces, kompania ofruese e shërbimit shtoi edhe 8 satelitë të tjerë pa asnjë pagesë ekstra për të na furnizuar me më shumë imazhe në ato periudha kohe", - tha Kryeministri. Duke folur për përmytjet, kryeministri Edi Rama tha se: "Harta satelitore e bën



të pamundur që një përmytje prej 3 km2 të kthehet në një përmytje prej 15 km2 duke shtuar aty viktima të ujit, e prona të dëmtuara për të rritur faturën në kurriz të shtetit, duke rritur dhe normën e korrupsionit. Kjo sepse janë imazhet dhe identifikimi i dëmeve, që deri dje bëhej me grupe në këmbë në terren mund ta bëjmë tani vetëm me një imazh". Kry-

eministri Edi Rama ftoi punonjësit e teknologjisë së informacionit - IT, që të punojnë për shtetin shqiptar, duke premtuar paga më të mira e konkurruese se në sektorin privat, krahasuar edhe me rajonin.

Gjatë aktivitetit, u prezantuan dhe dy shembuj konkretë ku Agjencia e Mbrojtjes Civile ka përfituar informacion të vlefshëm përmes satelitëve,

siç është rasti i zjarrit në ishullin e Sazanit, ngjarje e ndodhur në qershor 2022, ndërsa rasti i dytë ka të bëjë me përmytjet në qarkun e Shkodrës, në fshatin Muriqan. Sipas përfaqësueses së Agjencisë së Mbrojtjes Civile, Gentiana Maçi ky monitorim ndihmon në parandalim dhe në ndërhyrje sa më efikase.

Një ekip ekspertësh nga të gjitha

institucionet kanë nisur prej kohësh trajnimin pranë "Satellogic" për përdorimin e teknologjisë të avancuar për përpunimin dhe analizimin e imazheve satelitore.

Ekipi i trajnuar i ASIG po ndërton raste dhe shembuj që do të jenë në ndihmë të institucioneve publike për të analizuar dhe marrë vendime në kohë sa më të shkurtër.



Forca Ajrore zhvillon analizën e gjashtëmujorit të parë të vitit 2023

Në Garnizonin Rinas, u zhvillua analiza e punës gjashtëmujore e Komandës dhe Shtabit të Forcës Ajrore nën drejtimin e komandantit të kësaj force gjeneral brigade Ylli Pulaj. Në këtë analizë morën pjesë drejtuesit e strukturave të Forcës Ajrore si dhe shefat e degëve dhe sektorëve në Shtabin dhe Komandën e Forcës.

Komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj pasi falënderoi komandantët e strukturave dhe shtabin e FAJ-së për punën e realizuar gjatë këtij 6-mujori, ia kaloi fjalën për prezantimin e materialit të analizës shefit të Shtabit të FAJ-së, kolonel Genci Petanaj.

Kolonel Petanaj në prezantimin e tij evidentoi arritjet dhe objektivat e realizuara gjatë këtij 6-mujori si dhe punën e bërë për realizimin e këtyre detyrave si: pjesëmarrjen në operacionet SAR dhe mbështetja ajrore në stërvitjet e përbashkëta në kuadër të Forcave të Armatosura, siç ishte pjesëmarrja në stërvitjen “Defender-23”.

Në drejtim të trajnimit të personelit, evidentojmë Kursin Bazë të Oficerit në specialitetin “Pilot ushtarak helikopteri”, ku vlen për t’u përmendur rihapja përsëri e këtij programi trajnues.

Gjithashtu në Bazën Ajrore Farkë, në kuadër të bashkëpunimit dypalësh



me Forcën e Sigurisë Kosovë, u krye trajnimi i 2 pilotëve kosovarë, faza e II, të cilët zhvilluan një program teorik dhe një sasi të konsiderueshme orësh fluturimi me helikopterin AB-206. Në këtë analizë u përmendën gjithashtu edhe disa vështirësi të hasura sidomos në drejtim të mirëmbajtjes së mjeteve ajrore, për të cilat u diskutuan edhe opsionet e mundshme për zgjidhjet e tyre.

Më pas kolonel Petanaj u ndal tek prioritetet dhe detyrat kryesore të Forcës Ajrore si: ndjekjen e punimeve vijuese në Bazën Ajrore Kuçovë, për ta shndërruar atë në

Bazë Ajrore Taktike të NATO-s, ndjekja e modernizimit të teknikës ajrore, duke marrë disa helikopterë të tipit “Black Hawk” nga SHBA-të, vazhdimësinë e projektit të SIVHA, realizimin e projektit për kompletimin e Forcës Ajrore me mjetet UAV dhe me elementët e Mbrojtjes Ajrore.

Në mbyllje të analizës, gjeneral brigade Pulaj falënderoi për punën e bërë, duke u shprehur se sugjerimet e dala nga kjo analizë do të përkthehen në plane e programe pune për 6-mujorin e dytë, në mënyrë që të realizohen të gjitha e objektivat që ka Forca Ajrore për 2023.



Përfundon me sukses misioni i kontingjentit të parë në Novo Selo, Bullgari

Kontingjenti i parë, i përbërë nga 30 (tridhjetë) ushtarakë efektivë të Repartit Ushtarak nr. 1010 (batalioni i parë i këmbësorisë Vau i Dejës, Shkodër), ka përfunduar me sukses misionin si pjesë përbërëse e k2k e Grup Batalionit të NATO-s, në Operacionin e Prezencës dhe Vigjencës së përforcuar (eAV), Novo Selo, Bullgari.

Efektivët e kontingjentit nën drejtimin e komandantit të misionit, kapiten Besnik Cenaj realizuan trajnimin sipas programeve të detajuara në përbërje të k2k e Grup Batalionit të NATO-s, në Operacionin e Prezencës dhe Vigjencës së përforcuar (eAV), Novo Selo, Bullgari.

Dorëzimi i detyrës iu bë kontingjentit të dytë, i cili është i përbërë nga efektivë të batalionit të tretë të këmbësorisë Poshnjë, Berat.



Atasheu ushtarak i Republikës së Kosovës, kolonel Enver Hoti, zhvilloi një vizitë në Qendrën e Zhytjes Pashaliman

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, Atasheu ushtarak i Republikës së Kosovës, kolonel Enver Hoti, zhvilloi një vizitë në Qendrën e Zhytjes së Forcës Detare. Atasheu Ushtarak i Republikës së Kosovës u prit nga komandanti i Flotijes Detare, Pashaliman, kapiten i rangut I Engjëll Sinanaj.

Pas takimit, nën drejtimin e komandantit të Qendrës së Zhytjes kapiten i rangut I Ferdinand Kreshpani, Atasheu Ushtarak i Kosovës, Komandanti FDP-së,

i shoqëruar nga Shtabi i Flotiljes Detare Pashaliman, ndoqën nga afër stërvitjen e përbashkët demonstruese, midis efektivëve të QZH dhe efektivëve të FSK-së. Në stërvitjen demonstruese u përpunuan elementë të kërkimit nënujor, kontrolli i anijes, si dhe elementët e dhënies së ndihmës së parë zhytësit dhe trajtimit mjekësor në dhomën hiperbarike.

Në përfundim të stërvitjes Atasheu Ushtarak i Republikës së Kosovës, falënderoi efektivin pjesëmarrës në stërvitje, Forcën Detare për bashkëpunimin, si dhe konfirmoi vijimin e bashkëpunimit midis dy vendeve tona.

Forca Tokësore, pjesëmarrëse e “Arcade Ledger” në Paderborn, Gjermani

Efektivë të Batalionit të Dytë të Këmbësorisë vijojnë me sukses stërvitjen, e koduar “Arcade Ledger”, e cila zhvillohet në Paderborn, Gjermani.

Kjo stërvitje zhvillohet në kuadër VJTF - 24.

Në këtë stërvitje trupat shqiptare trajnohen së bashku me trupat e vendeve të NATO-s dhe atyre partnere: Angli, Turqi, Poloni, Francë, Gjermani, Hungari, Australi, Kanada, Itali, Letoni, Gjermani, Spanjë, si një njësi e përbashkët nën komandën angleze.

Qëllimi i kësaj stërvitjeje është rritja e kapaciteteve operacionale të reparteve dhe nënreparteve VJTF (L). Kjo stërvitje konsiston në rritjen e aftësive luftarake të vendeve anëtare të NATO-s. Pjesëmarrja e trupave të Forcës Tokësore në stërvitjen “Arcade Ledger” vjen në vijim të disa stërvitjeve ndërkombëtare, që po zhvillohen këtë vit nga Forca Tokësore, në kuadër të plan-kalendarit të stërvitjeve vjetore. Synimi i tyre është rritja e aftësive operacionale dhe ndërvepruese e këtyre forcave në një mjedis operacional ndërkombëtar.



Sesion Shkencor: Krijimi i Shtabit të Përgjithshëm dhe sfidat për organizimin dhe drejtimin e formacioneve të mëdha, si BrS të UNÇSH

Instituti i Studimeve të Historisë Ushtarake organizoi në sallën e bibliotekës së Akademisë së Shkencave, sesionin përkujtimor - shkencor me rastin e 80-vjetorit të krijimit të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇL, si dhe të formacioneve të mëdha taktiko-operative të krijuar nga data 4 gusht deri më 28 dhjetor 1943. Në aktivitet ishin të pranishëm edhe ushtarakët e karrierës, ish-gjeneralët Dedë Prenga dhe Perlat Sula, si dhe studiues dhe historianë të fushës ushtarake.

Aktiviteti u moderua nga prof. asoc. dr. Teki Kurti, drejtor i Arkivit të Forcave të Armatosura. Fjala e hapjes të Sesionit Shkencor u mbajt nga prof. dr. Proletar Hasani, drejtor Ekzekutiv i Institutit të Studimeve të Historisë Ushtarake, i cili foli mbi rëndësinë e mbajtjes të këtyre aktiviteteve, nga ana historike dhe jo vetëm.

Në aktivitet studiuesit dhe historianët ushtarakë kumtuan punimet e tyre, nëpërmjet të cilave sollën fakte të reja historike, hulumtuar si nga arkivat në vend por edhe nga arkivat ndërkombëtare, Gjermani, Mbretëri e Bashkuar etj.

“Krijimi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, si domosdoshmëri në sfidën për organizimin e formacioneve luftarake dhe drejtimin e tyre gjatë LANÇ”, ishte tema e sjellë në sesion nga msc. Sali Onuzi dhe dr. Asllan Zemani, parë në këndvështrimin historik. Një temë të cilën studiuesit e sollën me origjinalitetin dhe veçoritë e veta organizative të kohës.

“Dukuri të organizimit ushtarak në Zonën e Parë Operative Vlorë-Gjirokastrë-Mallakastër 1943-1944”, tema tjetër e mbajtur nga prof. asoc. dr. Bernard Zotaj, i cili trajtoi gjithashtu edhe një sërë çështjesh sociale të lidhura me sfidat që mbart periudha e luftës NAÇL.

Msc. Bashkim Qeli solli në studimin e tij “Lindja e roli i Br. I S, si formacion i parë i madh luftarak dhe model për formacionet e tjerë të këtyre dimensioneve. Dukuri e veçori, arritje e mangësi”, ku studiuesi trajtoi domosdoshmërinë e krijimit të kësaj brigade dhe sfidat dhe rolin e saj historik.

“Veçoritë, kushtet e lindjes, tek roli dhe sfidat e Br.IIS në veprimet luftarake të UNÇSH-së”, ishte tema tjetër e ndjekur me interes nga të pranishmit. Ky studim ishte përgatitur nga prof.



asoc. dr. Zaho Golemi, aktualisht shef i Sektorit të Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Inovacionit në Akademinë e Sigurisë.

Me interes gjithashtu u ndoq edhe tema “Dukuri të krijimit të Br.IVS të UNÇSH-së dhe zona e veprimit të saj”. prof. asoc. dr. Edmond Braneshi dhe dr. Jorgji Qirici sollën në studimin e tyre fakte të reja nga burimet arkivore rreth zonës së veprimit të Br.IVS të UNÇSH-së, në zonën ku ajo veproi gjatë Luftës NAÇL.

Sekretaria e sesionit shkencor të Institutit të Studimeve të Historisë Ushtarake arkivoi gjithashtu një numër kumtesash të tjera, ku vlen për t'u përmendur kumtesa “Lindja e vështirë në sfidën e luftës të Br.IIIS, karakteristikat, arritjet dhe dëmtimet e saj”, përgatitur nga dr. Hekuran Rrapaj.

PËRTEJ OQEANIT ME ZEMËR NË ATDHE

Ushtarakët shqiptarë në NY festojnë 4 Korrikun, Ditën e Pavarësisë së SHBA-ve

Shoqata e Ushtarakëve Shqiptarë “Association of SKËNDERBEJ USA” në NY-NJ, anëtarët e saj dhe familjarë të tyre, u mbledhën në një drekë festive për Ditën e Pavarësisë së SHBA-ve. Është një traditë e krijuar tashmë nga kjo Shoqatë festimi i kësaj date, jo vetëm për mirënjohjen për pritjen dhe mundësinë për të ndërtuar jetën në këtë vend ëndërrash, por edhe për të nderuar vlerat e përbashkëta që dy vendet tona ndanë në Luftën e Dytë Botërore si pjesëtarë të Aleancës Antifashiste, për të nderuar kontributet e Presidentëve Wilson dhe Clinton në jetën e Kombit Shqiptar për krijimin e dy shteteve tona.

Festën e bëri edhe më të bukur prania e përfaqësuesve të Shoqatës Atdhetare “Bijte e Shqipes” në Filadelfia dhe Forumit Ushtarak të saj, si dhe përfaqësuesit e Organizatës së Veteranëve të UÇK-së, dega e Amerikës.

Festa filloi me tingujt e Himnit të SHBA-ve dhe Himnit të Flamurit.

Presidenti i Shoqatës, prof. asoc. dr., kol. (P) Gëzim Mustafaj përshëndeti të pranishmit dhe bëri një historik të shkurtër të rrugës së SHBA-ve nga 4 korriku i 1776-s, të marrëdhënieve shqiptaro - amerikane.

Përshëndeti z. Ali Sopi në emër të “Bijve të Shqipes” dhe z. Astrit Huskaj në emër të Veteranëve të UÇK-së, i cili i dha Shoqatës “SKËNDERBEJ” një Certifikatë Mirënjohjeje për merita në shërbim të çështjes kombëtare, dhe një Mirënjohje tjetër për Kundëradmiralin në pension Muharrem Kuçana.

Dhe pastaj këngë e valle në një mjedis të gëzuar, ku shokë e miq, shumë prej tyre kolegë në vitet e rinisë e më pas gjatë punës në radhët e Ushtrisë Shqiptare. Disa, si Tefik Tuga apo Pashk Lugja vijnë për herë të parë në takimet e Shoqatës dhe u bënë përshtypje organizimi deri në detaje i festës nga Dirka Xhakolli, Gëzim Shentolli, Përparim Seitaj, Bashkim Dobrusha, Flutura Zekaj dhe DJ Agim Shiqeruka.

Kurse veterani gramshiot Mërkur Qose ka ardhur jo vetëm me familjen e vajzës, Artës, ushtarake e liruar, tashmë infermiere në NY, por edhe me vajzën tjetër që këto ditë ka ardhur nga Shqipëria për të takuar motrën dhe familjen e saj, e për të parë, sigurisht, New York-un.

Dhe ja një moment që merr vëmendjen dhe duartrokitjet e

të pranishmëve: kamerierët sjellin një tortë datëlindjeje, mbi të cilën bie në sy një foto dhe një kapele ushtaraku. Kol (P) Astrit Xhakolli, një nga nismëtarët dhe veprimtarët më aktivë të Shoqatës “SKËNDERBEJ” ka 70-vjetorin! Astriti ndihet sa i befasuar aq dhe i emocionuar nga ky nder që i bënë shokët dhe kolegët dhe i falënderon nga zemra.

Ndërsa Mihal Jano ka diçka për t'u dhuruar veteranëve të UÇK-së: një Histori të Skënderbeut, “Kryqtari i Fundit” të Virgjit Kules, dhe një Histori të LNC të Popullit Shqiptar.

Për rreth katër orë mjediset e lokalit u mbushën me tingujt e biseda festive, me kënaqësinë dhe gëzimin që sjell takimi i shokëve e miqve në një festë të bukur, siç është “4th of July”, kjo ditë e shenjtë e vendit që na u bë atdhe i dytë.



Batalioni i Xhenios në rrugëtimin e tij mes arritjesh dhe sfidash



INTERVISTOI: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Kolonel Shkëlzen Mhillaj, komandant i Batalionit të Xhenios, me një formim dhe karrierë të pasur ushtarake, vjen për lexuesin tonë nëpërmjet kësaj interviste, për të sjellë një pjesë të aktivitetit të Batalionit të Xhenios, si një prej institucioneve elitare të Forcave të Armatosura.

Kolonel Shkëlzen Mhillaj, ka ushtruar detyra të ndryshme përgjatë ushtrimit të detyrës në uniformën ushtarake, si: Komandant i Qendrës Menaxhimit të Materialeve; Përgjegjës Sektori në QBO; Komandant i Qendrës Stërvitore të KM-së; Shef Degës Planifikimit në Komandën Mbështetëse; Oficer Shtabi në Komandën Mbështetëse; Shef Seksioni në QBO; Komandant i Regjimentit Mbështetës; Komandant i Qendrës AEM; Komandant i Grup-depove; Komandant i Grupit AEM; Specialist Armatim-Municioni në Brigadën e Transportit; Shef i Trupës Mësimore në Shkollën e Trupës; Shef i seksionit të Armatim-Municionit.

Arsimimi: Fakulteti Juridik, Kursi Themelor i Oficerit të Shtabit, Master Shkencor në Akademinë e Forcave të Armatosura, Kursin e Lartë i Oficerit. Kursi për Marrëdhëniet Ndërkombëtare, Qendra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Diplomaci, Kursi Themelor i Oficerit të Shtabit, Akademia Ushtarake e Forcave Tokësore; Shkolla e Mesme e Përgjithshme, “Bris”. Kursi për Procedurat e Sigurisë EOD; Kursi Didaktik; Kursi i Azhurnimit EOD; Kurs për Menaxhimin e Municioneve sipas Standardeve të NATO-s.

Medalje e Karrierës (mbi 30 vjet), dhënë nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA. Është vlerësuar me Medalje për Shërbime të Shquara, dhënë nga Ministri i Mbrojtjes; Medalje për Shërbime të Veçanta, dhënë nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA; Medalje “Shpëtoj Jetë”, dhënë nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA; Medalje për Shërbime të Veçanta, dhënë nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA. Medalje e Karrierës (mbi 15 vjet), dhënë nga Komandanti i Forcës. Medalje e Karrierës (mbi 10 vjet), dhënë nga Komandanti i Forcës.

Në cilin vit ka filluar aktivitetin e tij Batalioni i Xhenios?

Batalioni i Xhenios është vazhdim i Batalionit Xhenier - Ndërtues, i cili u krijua më 1 korrik 1968, si vazhdimësi e batalionit të mekanizmave të rëndë, ose Rep. Usht. Nr. 2261, i pajisur me teknikë xheniere dhe gërmuese e mjete transporti. Batalioni kishte për detyrë kryerjen e punimeve të ndryshme speciale, për t’u ardhur në ndihmë reparteve të tjerë xhenierë, në kryerjen e detyrave të vendosjes së reparteve të FA-së në kazerma dhe veçanërisht në punimet fortifikuese mbrojtëse.

Pas viteve 90 struktura e batalionit xhenier ka pësuar ndryshime të shpeshta strukturore, në përshtatje edhe me ndryshimet e bëra në strukturën e FA-së. Reparti Ushtarak 2261 merr numrin Reparti Ushtarak 1025. Nga viti 2014 batalioni i xhenios ka në strukturën e tij edhe nënrepartin



Kolonel Shkëlzen Mhillaj,
komandant i Batalionit të Xhenios

EOD (Asgjësimi i Municioneve Eksplozive), nga i cili janë kontrolluar dhe pastruar nga municionet dhe minat me dhjetëra zona të “ndotura”, duke kontribuar ndjeshëm në rritjen e sigurisë në vend.

Krahas përmirësimit të infrastrukturës në njësitë dhe repartet e FA-së, batalioni xhenios ka kontribuar në përmirësimin e infrastrukturës në disa komuna e bashki të vendit për ndërtimin e rrugëve dhe urave mekanike, pastrimin e zonave (hotspot) dhe asgjësimin e municioneve tepër dhe jashtë nevojave të FA-së.

Cili është misioni i tij?

Misioni i Batalionit të Xhenios është sigurimi dhe mbajtja në gatishmëri e kapaciteteve të nevojshme operacionale për kryerjen e operacioneve të emergjencave civile, humanitare dhe ato në ndihmë të popullsisë, mbështetja

e strukturave të Forcave të Armatosura për zhvillimin e infrastrukturës, kërkimi, zbulimi, çminimi dhe asgjësimi i municioneve të rrezikshme dhe lëndëve plasëse në operacione brenda dhe jashtë vendit.

Cilat janë disa prej detyrave që realizon Batalioni i Xhenios?

Të sigurojë dhe mbështesë përmirësimin e infrastrukturës së FA-së, poligone stërvitje dhe rrjetin rrugorë. Të sigurojë kapacitetet për riparimin dhe ndërtimin e urave në interes të FA-së dhe komunitetit. Të sigurojë kapacitetet dhe të marrë pjesë në operacionet humanitare dhe përballimin e EC-ve. Të sigurojë kapacitete për mbështetjen e infrastrukturës (ndërtime, riparime, rehabilitime, mirëmbajtje dhe modifikime) të vendkomandave, kampeve “transit” dhe të përkohshëm, të aeroporteve dhe

rrugëve kryesore. Të sigurojë kapacitetet e përcaktuara për pjesëmarrje në operacionet e NATO-s.

Të mbështesë operacionet ushtarake të kërkimit, eksplorimit dhe pastrimit të minave në zona ushtarake ose mjedise të tjera, si dhe të përcaktojë shkallën e ndërhyrjes e të mbështetjes.

Cila është struktura e Batalionit të Xhenios dhe cili është profili arsimor i burimeve njerëzore që bëhen pjesë e saj?

Batalioni i Xhenios përbëhet nga shtabi i batalionit, i cili ka në përbërje specialistë xhenierë, infrastrukture, EOD, logjistike, operacionesh, zbulimi, ndërlidhje etj.

Operacionet xheniere kryen nga Kompania e Punimeve Xheniere nëpërmjet togave të transportit, mjeteve të rënda dhe ndërtimit.



Operacionet EOD planifikohet dhe zhvillohen nga shtabi dhe kompania EOD me përbërje prej 5 togash EOD.

Detashmenti i Urave është nënreparti i cili bën të mundur ndërtimin e urave me konstruksion metalik të tipit Bailey.

Kompania Mbështetjes është nënreparti që mbështet shtabin dhe n/repartet e tjera për realizimin e detyrave me shërbime logjistike dhe ato teknike.

Cilat janë operacionet për mbrojtjen ekologjike, po ato mjedisore?

Batalioni i Xhenios përveç operacioneve dhe detyrave për përmirësimin e infrastrukturës ushtarake është angazhuar edhe në operacionet e Emergjencave Civile, ku mund të përmendim operacionet për shuarjen e zjarreve në Sazan dhe Mirditë (2022), operacionet plazhet e pastra, ku janë angazhuar forca dhe mjete të batalionit në vijën bregdetare nga Velipoja në Sarandë, operacionet për rehabilitimin e infrastrukturës së dëmtuar nga reshjet në Qarkun Tropojë (2022).

Operacionet EOD që kryen batalioni i xhenios janë gjithashtu në interes të mbrojtjes ekologjike dhe mjedisore. Çdo vit kompania EOD asgjëson municione dhe eksplozivë të gjetur në të gjithë Shqipërinë, ku mund të përmendim operacionin aktual për pastrimin nga municionet e paplasura të shtratit të lumit Bënçë në Tepelenë, ku deri tani janë gjetur rreth 40 ton municione që datojnë nga Lufta e Dytë Botërore.

Ju jeni pararoja e FA-së në ndihmë të komunitetit.

Cilat kanë qenë disa nga angazhimet tuaja në këtë drejtim?

Përveç operacioneve që kryen për përmirësim infrastrukturë në Forcat e Armatosura, batalioni i xhenios është i angazhuar dhe për ndërtimin e urave tip “Bailey” nëpër bashki dhe komuna në zona të thella për të mundësuar përmirësimin e infrastrukturës lokale dhe lidhjen e fshatrave. Gjithashtu ky batalion ka punuar për përmirësimin e rrugëve dhe infrastrukturës në komunitet, ku mund të përmendim punimet për Aeroportin e

Lumalasit dhe hapjen e rrugës Panarit-Treskë në Bashkinë Korçë.

Këtë 6-mujor jemi angazhuar në operacionin për rehabilitimin e shpellës së pelegrinazhit “Teqja e Ballëm Sultan”, në njësinë Administrative Martanesh si dhe prishjet e kontrolluara të masive shkëmbore në fshatin Mamël bashkia Librazhd dhe fshatin Gracen, bashkia Cërrik, masive shkëmbore që rrezikojnë prishjen e shtëpive në këto fshatra.

Në vite keni bërë të mundur lidhjen e komuniteteve me njëri-tjetrin nëpërmjet ndërtimit të urave “Bailey”. Sa të tilla keni mundur të realizoni dhe a disponojnë Forcat e Armatosura, burimet njerëzore dhe ato logjistike për realizimin në kohë reale të tyre?

Batalioni i Xhenios nëpërmjet forcave dhe mjeteve të Detashmentit të Urave për 6-mujorin e parë të vitit 2023 ka ndërtuar 13 ura tip “Bailey”, 210 ml ura në Bashkitë Maliq, Klos, Krujë, Darzezë Fier, Tropojë, Librazhd, Korçë dhe në ndërtim është një urë në bashkinë Finiq.

Batalioni i xhenios i ka kapacitetet njerëzore dhe logjistike për realizimin në kohë të këtyre detyrave. Ndërtimi i këtyre urave bëhet në koordinim dhe mbështetjen e bashkive ku ndërtohen urat. Për rritjen e kapaciteteve operacionale Batalioni i Xhenios ka gjeneruar dhe kërkesat operacionale për kompletimin me pajisje dhe teknike aktuale për realizimin e misionit.

Ju kryeni dhe një prej misioneve më të rëndësishme dhe të rrezikshme, atë të eksplorimit dhe pastrimit të minave në zona ushtarake ose mjedise të tjera.

Si realizohet aftësimi i personelit për t’iu përgjigjur kërcënimeve dhe rreziqeve në realizimin e misionit?

Siç e përmendët efektivat xhenierë dhe ato EOD (Asgjësimi i Municioneve Eksplozive) angazhohen në detyra që kanë një shkallë rrezikshmërie shumë të lartë për jetën e tyre për të reduktuar dhe eliminuar rrezikun që vjen nga municionet dhe eksplozivët e paplasura që kërcënojnë personelin, instalimet ushtarake, operacionet, popullsinë e pronën si brenda, dhe jashtë vendit, në kuadër të operacioneve të NATO-s, BE-së dhe OKB-së.

Efektivat EOD sot janë të angazhuar në Bazën Ajrore Kuçovë, në pastrimin e poligonit Voskopojë, në rehabilitimin nga municionet të shtratit të lumit Bënçë Tepelenë, sistemim dhe paletizim municionesh në grup-depot Mirakë, Elbasan.

Përveç detyrave dhe operacioneve të shumta EOD që këta efektiva zgjidhin gjatë gjithë vitit, Batalioni i Xhenios që nga viti 2017 vazhdon angazhimin me një togë EOD në misionin e NATO-s, eFP (Enhanced Forward Presence) - Prezenca e Përpunuar e Shtuar në Letoni. Në qershor kontingjenti 13 EOD vazhdon misionin dhe ka deklaruar kapacitetin e plotë operacional për mision.

Për realizimin e misionit EOD për eliminimin kërcënimeve dhe rreziqeve që vijnë në municionet e paplasura, prioritet për batalionin e xhenios ka qenë dhe mbetet trajnimi dhe kualifikimi i personelit EOD me kurset dhe kualifikimet përkatëse. Batalioni i Xhenios mbështet zhvillimin e kurseve EOD në Qendrën Stërvitore të Komandës Mbështetëse, ku zhvillohen kurset EOD Niveli I, II dhe III. Aktualisht në këtë qendër po zhvillohet kursi EOD Niveli III dhe ky kurs po asistohet dhe nga pala amerikane nëpërmjet Zyrës së Bashkëpunimit për Mbrojtjen ODC.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Nuk është e lehtë të plakesh me dinjitet... Duhet të pranosh lëkurën e re, “brazdat” e reja, pamjen e re... Duhet të bësh paqe me frymëmarrjen më të shkurtër, me rimëkëmbjen më të ngadaltë pas sëmundjeve, me nyjat që dhembin, me venat, me flokët e bardhë që dalëngadalë ia zënë vendin valëzimit të flokëve plot jetë të rinisë...

Duhet ta pranosh dhe ta duash veten në një epokë të re, të rikrijosh vetveten, të vazhdosh te jesh kureshtar, të qeshësh dhe të vazhdosh “të pastros” dhëmbët për t’i bërë ata të shkëlqejnë përsëri...

Duhet të kultivosh ironinë, të kuptosh që mund të vazhdosh të gabosh, të zgjedhësh njerëz të tjerë me kujdes, të dalësh nga vetvetja, të kthehesh te ajo, të këndosh, të mallkosh “mësuesit” e jetës, të tallesh me frikën, të jesh krenar dhe të pranosh trupin tënd...

Nuk do jetë e lehtë, por së paku përpiqu të vjetërsohesh si vera, të “parfumosh” dhe të shijosh si ajo edhe me kalimin e viteve...

Problemi kryesor në modernitet është përballja me një krizë morale të përmasave të mëdha. Jetojmë në shoqërinë e bollëkut material, por në të njëjtën kohë përballemi me humbjen e arsyes dhe absolutes morale. Më së shumti kultura perëndimore rrezikohet nga pikëpamja e pakët e dinjitetit njerëzor.

“Dinjiteti nuk bie nga qielli. Ai nuk mund të blihet dhe as të shpiket. Dinjiteti është shpërblim i rezervuar për ata që punojnë me ndërgjegje”

Në jetën e përditshme na takon shpesh të dëgjojmë të flitet për njerëz me dinjitet, të dinjitetshëm, dinjitarë etj., dhe po kaq shpesh për individë pa dinjitet. Dinjiteti është një tërësi vlerash morale tek njeriu dhe, në mënyrë të veçantë, vetëdija që ka individ për këto vlera, vetëdije që manifestohet në sjelljet dhe qëndrimet e njeriut ndaj të vërtetës, të drejtës dhe të moralshmes. Në historinë e njerëzimit ka pasur prirje për ta matur dinjitetin e individit në raport me pasurinë apo pozitën e tij në shoqëri, por koha ka provuar se dinjiteti është një pasuri morale individuale.

Ashtu si karakteri dhe personaliteti që i hedhin rrënjët tek njeriu qysh në moshë të re, edhe dinjiteti si formë e shfaqjes së tyre fillon të manifestohet mjaft herët dhe e shoqëron njeriun gjatë gjithë jetës. Përgjithësisht dinjiteti i individit përcaktohet nga sjelljet dhe qëndrimet që mban ai kundrejt individëve të tjerë, familjes dhe shoqërisë në tërësi, dhe nga shkalla e përputhjes së këtyre sjelljeve e qëndrimeve me kodin moral të shoqërisë.

Në Shqipëri dhe jashtë saj kemi parë dhe mund të gjejmë me mijëra individë “të famshëm”, të pasur apo politikisht të pushtetshëm, të cilët sillen e veprojnë pa kurrfarë dinjiteti.

Para fushatës së pasuksesshme turke për rusët në 1711, sundimtari moldav, Princi Cantemir, hyri nën patronazhin e Pjetrit të Madh. Në përfundim të paqes me turqit, Pjetrit iu dha një nga kushtet e propozuara nga Veziri i Madh: ekstradimi i Kantemirit. Disa nga të afërmit e bindën Pjetrin të pajtohej me kushtet e armikut. Duke e shtyrë perandorin drejt tradhtisë, ata e siguruan Pjetrin se fjala që i kishte dhënë Kantemirit ishte vetëm një fjalë; se, pasi ka tradhtuar sundimtarin moldav, Pjetri nuk do ta njollosë shpirtin e tij me mëkat. Megjithatë, Pjetri qëndroi i palëkundur dhe pushoi së rënuari, duke thënë: “Më mirë do t’ua dorëzoja tokën turqve deri në Kursk sesa të pajtohesha me këtë. Do të kem shpresë për të rifituar atë që më është dhënë, por të mos mbaj fjalën do të thotë të humbas përgjithmonë nderin”.

Një njeri i nderuar ka shumë virtyte, ai karakterizohet nga sinqeriteti, fisnikëria e shpirtit, qëllimi i ndershëm dhe i drejtpërdrejtë për t’iu përmbajtur marrëveshjeve të arritura më parë, ndërgjegjja, mirësjellja, guximi dhe ndërgjegjja e pastër. Nderi e zbukuron njeriun.

Shekspiri ka thënë: *“Nuk është veshja ajo që e zbukuron njeriun. Ndërsa dielli shkëlqen nga pas reve të zeza, kështu nderi shkëlqen nën rrobat e varfra”*.

Mosmarrëveshjet e një personi me nder në çdo kohë u ndëshkuan ashpër në Rusi. “Nderoni shkëljen”, - kështu u quajtën dënimet e turpshme sipas neneve ushtarake të Pjetrit të Madh.

Jo vetëm një oficer (nderi i oficerit), një kalorës (nderi i kalorësit), një tregtar (nderi i tregtarit) ose çdo anëtar tjetër i një grupi të

Nuk është e lehtë të plakesh me dinjitet...



privilegjuar, por edhe çdo qytetar mund të bëhet pronar i nderit si një tipar personaliteti.

Në vitin 1902, qeveria cariste refuzoi të zgjidhte Maxim Gorky-n për akademik nderi. Në shenjë proteste, Korolenko dhe Chekhov refuzuan titullin akademik. Për Çehovin, ky nuk ishte vetëm një akt publik, por edhe personal. Ai shkroi në një deklaratë se kur Gorki u zgjodh, e pa atë dhe ishte i pari që e uroi.

Nderi nënkuptonte ndjekjen e një sistemi rregullash që e dallonin këtë grup nga të tjerët dhe theksonin statusin e tij të lartë.

Në epokën tonë të egoizmit dhe injorancës, kur shumë grupe elitare janë zhdukur, është bërë më e vështirë të jesh “skllav i nderit”.

Kanë mbetur pak njerëz në këtë botë që janë në gjendje të japin jetën për hir të nderit dhe të drejtës për t’u quajtur burrë.

Duhet shumë guxim për ta bërë këtë...

Turpi dhe nderi janë si një fustan, varet se çfarë përmasash trupore ke, për të qëndruar ‘denjësisht’ brenda tij.

Një njeri i nderuar është një njeri parimor që ndjek rregullat e pashkruara të çdo grupi ose strukture vetëm kur ato përputhen plotësisht me pikëpamjet dhe parimet e tij.

Një njeri i nderuar e kupton se pas nderit të tij personal qëndron nderi i të barabartëve të tij dhe, për këtë arsye, duhet të sillet pa kompromis dhe luftarak.

Kategoritë “nder” dhe “dinjitet” pasqyrojnë vlerën morale të individit, ato përfaqësojnë një vlerësim publik dhe individual të cilësive dhe veprimeve morale të një personi. Nderi si një fenomen moral është, para së gjithash, një njohje e jashtme publike e veprimeve të një personi, meritave të tij, të manifestuara në nderim, autoritet, lavdi. Prandaj, ndjenja e nderit e natyrshme tek individ shoqërohet me dëshirën për të arritur vlerësim të lartë nga të tjerët, lavdërime, famë. Dinjiteti është besim i brendshëm në vlerën e dikujt, një ndjenjë respekti për veten, e manifestuar në rezistencën ndaj çdo përpjekjeje për të cenuar individualitetin dhe një pavarësi të caktuar.

Një person është i pajisur me dinjitet që nga momenti i lindjes, ai mund të rritet që në moshë të re. Nderi fitohet gjatë gjithë jetës. Dallimi midis nderit dhe dinjitetit manifestohet kur bëhet fjalë për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut: ne mund të mos tregojmë nder, respekt, nder ndaj një personi, por duhet të llogarisim me dinjitetin e tij njerëzor.

Shfaqja më e lartë e dinjitetit njerëzor është fisnikëria - madhështia morale e personit njerëzor. Mund të jetë e natyrshme për çdo person

që përmbush me ndershmëri detyrën e tij, jeton sipas standardeve morale. Një person i kapur nga etja për pasurim, një skllav i karrierës dhe i parave, është i privuar nga vetëvlerësimi. Kushdo për të cilin veprimtaria shtetërore apo publike është vetëm arenë e ambicies së tij personale, nuk ka nder në sytë e shoqërisë dhe rrezikon të humbasë dinjitetin e tij njerëzor.

Një tregues i dinjitetit të një personi është qëndrimi i tij ndaj dinjitetit të një personi tjetër. Të durosh shpifjet, mashtrimin do të thotë të mos respektosh veten dhe të tjerët.

Si të mos humbni dinjitetin dhe nderin?

Duke bërë diçka që është kundër nderit të dikujt, duke humbur dinjitetin, njeriu humbet jo vetëm besimin në vetvete. Ai e privon veten nga një ndjenjë besimi, respekti për veten dhe zhytet në humnerën e dëshpërimit dhe poshtërimit të vetvetes.

Zakonisht, ai që humbi veten shpesh nuk e dëshironte një përfundim të tillë. Për t’u rikuperuar në sytë e tij dhe të atyre që e rrethojnë, ai do të duhet të kuptojë se si të rregullojë atë që ka bërë: ai duhet të zhvillojë një plan se si do të korrigjohet dhe kompensohet dëmi. Pavarësisht se sa e vështirë mund të duket.

Kujdes nga njerëzit që arrijnë qëllimet e tyre përmes manipulimit. Ata nuk kujdesen për ju apo mirëqenien tuaj. Ata kanë interesa ndaj jush. Dhe meqë ra fjala, ky është lloji i njerëzve që do t’ju thonë me këmbëngulje se janë miqtë tuaj. Mos u mashtroni nga kjo.

Në kohët e vjetra njerëzit kishin frikë të humbnin nderin, e mbronin atë dhe vdisnin për të në duele. Tani, natyrisht, nuk ka një gjë të tillë, por kjo nuk do të thotë se ai nuk është i pajisur me këtë cilësi. Të gjithë duhet ta njohin nderin.

A ka çdo njeri nder dhe dinjitet

• Nderi është një ndërgjegje e jashtme dhe ndërgjegjja është një nder i brendshëm, - Arthur Schopenhauer.

• Nderi i vërtetë është vendimi për të bërë në çdo rrethanë atë që është e dobishme për shumicën e njerëzve, - Benjamin Franklin.

• Nderi im është jeta ime; të dyja rriten nga e njëjta rrënjë. Ma hiq nderin dhe jeta ime do të mbarojë, - William Shakespeare.

• Nderi është diamanti në dorën e virtytit, - Volteri.

• Nderi i secilit do t’i jepet pasardhësve të tij, - Tacitus.

Dinjitet është identitet. Thonë se një njeriu po i hoqe dinjitetin, i ke hequr gjithçka. Kemi një emër dhe një mbiemër për t’u dalluar nga njëri- tjetri, sikundër kemi edhe një dinjitet që na identifikon.

Ballkani Perëndimor, NATO i bën thirrje Prishtinës dhe Beogradit: Është urgjente, ndërmerrni hapa të menjëhershëm drejt de-përshkallëzimit

PËRSHTATI: MIMOZA GOLIKJA

NATO thekson nevojën për de-përshkallëzimin për siguri të qëndrueshme në Kosovë dhe stabilitet në Ballkanin Perëndimor.

Ndihmës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s për Operacionet, Tom Goffus, përsëriti përkushtimin e palëkundur të NATO-s për të promovuar stabilitetin rajonal gjatë vizitës së tij në Kosovë, më 5 korrik 2023. Z. Goffus u takua me përfaqësues të institucioneve në Kosovë, si dhe me komandantin e misionit të KFOR-it të udhëhequr nga NATO, Shefin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) dhe përfaqësues të tjerë të bashkësisë ndërkombëtare.

“Është urgjente që si Prishtina ashtu edhe Beogradi të ndërmarrin hapa të menjëhershëm drejt de-përshkallëzimit, është gjithashtu thelbësore që të dyja palët të koordinojnë siç duhet veprimet në terren dhe të respektojnë marrëveshjet ekzistuese”, - tha ai. “Ndërsa KFOR-i është i domosdoshëm në mjedisin e vazhdueshëm, zgjidhja për stabilitet të qëndrueshëm është një zgjidhje politike. Është kritike që Kosova dhe Serbia të angazhohen në mënyrë konstruktive në dialogun e lehtësuar nga BE-ja. Ne u bëjmë thirrje të dyja palëve që sa më shpejt të jetë e mundur dhe në tërësi të zbatojnë Marrëveshjen Themelore dhe Aneksin e Zbatimit të saj të rënë dakord në Ohër”, - tha ai. “Misioni ynë i KFOR-it vazhdon të ofrojë një mjedis të mbrojtur dhe të sigurt në Kosovë në përputhje me mandatin tonë, bazuar në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, të vitit 1999”, - tha ai.

Askush nuk duhet të rrezikojë një tjetër konflikt në Evropë

“Jam këtu në Prishtinë për të theksuar përkushtimin e palëkundur të NATO-s për një rajon paqësor dhe të qëndrueshëm të Kosovës dhe Ballkanit Perëndimor”, - tha që në hyrje të deklaratos së tij zyrtari i lartë, Ndihmës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s për Operacionet, Tom Goffus.

“Pavarësisht thirrjeve të përsëritura nga NATO dhe komuniteti më i gjerë ndërkombëtar si për Beogradin ashtu edhe për Prishtinën, ne nuk kemi parë asnjë përparim drejt de-përshkallëzimit dhe kjo rrezikon mbrojtjen dhe sigurinë e të gjithë njerëzve në Kosovë, si dhe atë të personelit të NATO-s”, - tha z. Goffus.

“Gratë dhe burrat e misionit tonë të KFOR-it kanë qenë në detyrë ditë e natë, për shumë vite, larg vendeve të tyre dhe familjeve të tyre, për të siguruar një mjedis të mbrojtur dhe të sigurt këtu në Kosovë. Këta janë të njëjtët burra dhe gra që më 29 maj pësuan sulme të paprovokuara dhe të papranueshme, duke lënë 93 prej tyre të plagosur, disa prej tyre rëndë”. Ndihmës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s tha se ky është numri më i madh i viktimave të KFOR-it në një ditë të vetme që nga viti 1999. “Kjo është absolutisht e papranueshme dhe nuk mund të ndodhë më. NATO ua ka bërë të qartë këtë qëndrim edhe autoriteteve serbe. Narrativat e rreme rreth rolit të KFOR-it janë gjithashtu të papranueshme”, - tha ai.

Zyrtari i lartë i NATO-s tha që Prishtina dhe Beogradi të ndërmarrin hapa drejt ç’ tensionimit. “Është urgjente që si Prishtina ashtu edhe Beogradi të ndërmarrin hapa të menjëhershëm drejt de-përshkallëzimit, në përputhje me planin trepikësh të BE-së. Është gjithashtu thelbësore që të dyja palët të koordinojnë siç duhet veprimet në terren dhe të respektojnë marrëveshjet ekzistuese”, - tha Goffus.

“Bashkëpunimi në kohë dhe kuptimplotë është i një rëndësie kyçe, - tha ai, - siç e kam theksuar edhe në takimet e mia të sotme. Bashkëpunimi efektiv është mënyra se si Kosova demonstroi se mund të jetë një partner efektiv i sigurisë për NATO-n. Fatkeqësisht, ne kemi parë një rënie në koordinimin tonë praktik dhe politik. Kjo bën ndesh me aspiratat euroatlantike të popullit kosovar. Unë gjithashtu kam ndarë pritshmërinë time më të fortë se të gjitha marrëveshjet me NATO-n do të respektohen dhe zbatohen. Kjo është thelbësore për të



siguruar që bashkëpunimi i fortë ndërmjet NATO-s dhe institucioneve në Kosovë të mos priset”.

Misioni i KFOR-it vazhdon të ofrojë një mjedis të mbrojtur dhe të sigurt në Kosovë në përputhje me mandatin bazuar në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, të vitit 1999. “Unë vizitova paqeruajtësit tanë në veri, duke përfshirë batalionin rezervë operacional të dislokuar në fillim të këtij muaji si rezultat për shqetësimet e shtuara të NATO-s për sigurinë dhe stabilitetin. Ushtarët e KFOR-it po bëjnë një punë të jashtëzakonshme”, - tha z. Goffus. “Ato kanë dëshmuar se janë të domosdoshëm, - tha ai, - e sidomos që nga viti i kaluar e në vazhdim, teksa po merren me këtë cikël tensioni dhe krize. KFOR-i do të vazhdojë të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të zbatuar mandatin e tij në mënyrë të paanshme. Ata mbeten të gatshëm të ndërhyjnë nëse situata e kërkon”.

“Ndërsa KFOR-i ka dëshmuar se është thelbësor në këtë mjedis, zgjidhja për stabilitet të qëndrueshëm është një zgjidhje politike”, - theksoi Ndihmës Sekretari i Përgjithshëm. “Është kritike që Kosova dhe Serbia të angazhohen në mënyrë konstruktive në dialogun e lehtësuar nga BE-ja. Ne u bëjmë thirrje të dyja palëve që të zbatojnë sa më shpejt dhe në tërësi Marrëveshjen Themelore dhe Aneksin e Zbatimit të saj të rënë dakord në Ohër (OKH-RIT)”, - specifikoi ai.

“Ky është një moment kritik për sigurinë në kontinentin tonë. Rusia ka rikthyer luftën në Evropë me pushtimin e saj të paligjshëm të Ukrainës. Populli i Kosovës dhe i gjithë rajonit të Ballkanit Perëndimor e di shumë mirë koston e tmerrshme të luftës. Askush nuk duhet të rrezikojë një tjetër konflikt në Evropë që do të minonte paqen dhe stabilitetin e fituar me një sakrificë të tillë. Faleminderit”, - mbylli deklaratën e tij Ndihmës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s për operacionet.

Beogradi dhe Prishtina të angazhohen me mirëbesim në dialog

NATO është deklaruar për situatën në Kosovë. Aleanca ka dënuar fuqishëm sulmet e paprovokuara kundër trupave të KFOR-it në veri të Kosovës, të cilat kanë çuar në plagosjen e një numri prej tyre. “Sulme të tilla janë krejtësisht të papranueshme. Dhuna duhet të ndalet menjëherë”, - tha në deklaratën e saj NATO, edhe më 29 maj 2023, për sulmet e paprovokuara kundër trupave të KFOR-it. “Ne u bëjmë thirrje të gjitha palëve që të përmbahen nga veprimet që nxisin më tej tensionet dhe

të angazhohen në dialog. KFOR-i do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të ruajtur një mjedis të mbrojtur dhe të sigurt dhe do të vazhdojë të veprojë në mënyrë të paanshme, në përputhje me mandatin e tij sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të vitit 1999”.

Duke vlerësuar situatën Aleanca vendosi të shtojë prezencën në mision. Përforcimet shtesë të NATO-s filluan të mbërrijnë në Kosovë, më 5 qershor 2023, pas dhunës së paprovokuar dhe të papranueshme që la pothuajse 40 trupa paqeruajtëse të KFOR-it të plagosur në përleshje. Rreth 500 pjesëtarë të shërbimit turk nga brigada e 65-të e mekanizuar e këmbësorisë së Turqisë përbënin pjesën më të madhe të përforcimeve të NATO-s. Batalioni u vendos në Kosovë për aq kohë sa të jetë e nevojshme. Një batalion shtesë i forcave rezervë të NATO-s është vënë gjithashtu në gatishmëri më të lartë për t’u vendosur nëse është e nevojshme.

Pas bisedimeve me Presidentin Recep Tayyip Erdogan në Stamboll gjatë atyre ditëve, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg falënderoi Turqinë për dërgimin e përforcimeve në Kosovë. Ai tha se: “Turqia është një aleate e rëndësishme dhe shumë e vlerësuar, duke dhënë kontribute kyçe në NATO. Këtu përfshihen trupat për misionin tonë paqeruajtës në Kosovë, gjë që është edhe më e rëndësishme tani, kur tensionet janë të larta. Falënderoj Turqinë për dërgimin e përforcimeve në veri të Kosovës, pas trazirave të fundit”, - tha ai.

Edhe në takimin e fundit jozyrtar të ministrave të Jashtëm të NATO-s në Oslo, Sekretari i Përgjithshëm i dërgoi një mesazh si Beogradit edhe Prishtinës. “Mesazhi ynë si për Beogradin ashtu edhe për Prishtinën është se ata duhet të angazhohen në mirëbesim në dialogun e lehtësuar nga BE; kjo është e vetmja rrugë drejt paqes. Në të njëjtën kohë, NATO ka përgjegjësi për të siguruar stabilitet në Kosovë dhe kjo është arsyeja pse ne kemi qenë atje për shumë vite dhe pse tani po rrisim praninë tonë në rajon”.

NATO ka udhëhequr operacionin paqeruajtës në Kosovë që nga viti 1999 në mbështetje të përpjekjeve ndërkombëtare për të ndërtuar stabilitet në rajon. Misioni i KFOR-it është të ruajë një mjedis të mbrojtur dhe të sigurt dhe lirinë e lëvizjes për të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë, në përputhje me mandatin e tij sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. KFOR-i aktualisht përbëhet nga mbi 4 500 trupa të kontribuar nga 27 aleatë dhe partnerë të NATO-s.



AGRON BERDAJ



ZENO JAHAJ

80 vjet nga krijimi i Shtabit të Përgjithshëm

10 Korriku 1943, data e krijimit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, e vendosur, nga qeveria e pasluftës, në kalendarin e festave shtetërore të Shqipërisë si festë e ushtrisë, është hequr si e tillë, nga qeveria e pas vitit 1991, duke qenë që ky shtab nuk ishte i pari shtab i përgjithshëm i ushtrisë së Shqipërisë.

Në respekt historik dhe institucional, qeveria e pas vitit 1991, vendosi që festë e ushtrisë të jetë data 4 Dhjetor, dita që qeveria e shtetit të sapo themeluar shqiptar krijoi Ministrinë e Luftës. Ajo qeveri, më 4 maj 1913 ngriti edhe shtab të përgjithshëm, të emërtuar “Shtati Madhnuer” e, më tej, “Shtabi Madhuer”. Ishte një hap që e kërkonte situata e ndërlikuar e brendshme dhe e jashtme ushtarake e kohës, por edhe kultura shtet-formuese e themeluesve. Organizimi i këtij Shtabi me një numër simbolik anëtarësh, si dhe zhvillimi i attributeve të tij, pavarësisht kufizimeve të pakapërcyeshme për shkak të rrethanave të kohës, përbën fillimin e konceptit dhe operacionalitetit të një shtabi të përgjithshëm ushtarak shqiptar në kuadër shtetëror.

Pas Qeverisë së Përkohshme të Ismail Qemalit dhe deri në ardhjen në fuqi të Mbretërisë Shqiptare, në Shqipëri u ndërruan 17 qeveri, jetëgjatësia e të cilave arrinte, e shumta, disa muaj - një paqëndrueshmëri që do të influenconte edhe strukturat ushtarake.

Mbretëria Shqiptare, në kuadër të konceptimit dhe ngritjes së një administrate shtetërore, ngriti edhe Ushtrinë Kombëtare, duke përfshirë edhe Shtabin Madhor. Sidoqoftë, fakti që ajo ushtri u shkri që në ditën e parë e të dytë të pushtimit italian, tregoi se nuk kishte qenë efektivisht operacionale në funksionim, duke përfshirë edhe Shtabin Madhor.

Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacional-Çlirimtare u krijua në kohë lufte, kur Shqipëria ishte e pushtuar nga fashistët italianë dhe e ushtrori veprimtarinë komanduese e drejtuese njëherësh edhe si Komandë e Përgjithshme.

Krijimi i Shtabit të Përgjithshëm u diktua nga faktorë të brendshëm dhe të jashtëm, që lidheshin me stadet e zhvillimit të Luftës së Dytë Botërore. Kapitullimi i Italisë fashiste, përkatësisht dorëzimi ushtrisë italiane dhe mbushja e boshllëkut të krijuar në territorin shqiptar nga trupat pushtuese gjermane, kërkonte një nivel më të lartë dhe më efektiv organizimi, komandimi dhe drejtimi të ushtrisë partizane, rritje të fuqisë goditëse dhe kombinim gjithnjë e më të gjerë të metodave të luftës partizane me ato të luftës frontale, si rrugë e vetme për t'u përballur me etapat në rritje të Luftës së Dytë Botërore në përgjithësi, të vetë Luftës Nacional-Çlirimtare Shqiptare, si dhe me formacionet e mëdha naziste që po pushtonin Shqipërinë.

Ky stad i ri i luftës partizane shtronte nevojën për krijimin, drejtimin dhe komandimin e njëjësive më të mëdha taktiko-operative, të shtrira në të gjithë territorin e Shqipërisë, si dhe gjetjen e administrimit e më shumë burimeve materiale (armatime, rezerva ushqimore, veshmbathje) në funksion të çlirimit të plotë të vendit.

Këto objektiva strategjike mund të realizoheshin vetëm me krijimin e një Shtabi të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, një nevojë strategjike që u shtrua që në Konferencën



e Pezës ku u krijua Fronti Antifashist Nacional-Çlirimtar. Nga kjo Konferencë deri më 10 korrik 1943, kur u krijua Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, ushtria partizane arriti një efektiv prej mbi 10 000 partizanë, të organizuar në 20 batalione dhe e mbështetur nga rreth 20 000 vullnetarë të organizuar në çeta territoriale të fshatrave të çliuara dhe në njësite guerile të qyteteve e të krahinave të pushtuara.

Krijimin e një organi të centralizuar dhe të specializuar për udhëheqjen e luftës, e kërkonte edhe nevoja e bashkërendimit dhe bashkëveprimit me aleatët e mëdhenj antifashistë e antinazistë, përkatësisht me Bashkimin Sovjetik, Britaninë e Madhe dhe SHBA-të. Sukseset ushtarake të aleatëve të mëdhenj ndaj forcave të Boshtit nazi-fashist, veçanërisht thyerja e ushtrisë gjermane në Stalingrad në shkurt 1943, shënuan një pikë kthese në historinë e Luftës së Dytë Botërore. Forcat e Boshtit e humbën iniciativën strategjike dhe fuqinë sulmuese dhe u detyruan të kalonin në operacione mbrojtëse. Iniciativa strategjike kaloi në anën e aleatëve të mëdhenj antifashistë e antinazistë, si dhe të vendeve të tjera të lidhura në këtë Aleancë, të cilat kaluan në fazën e planëzimit dhe realizimit të operacioneve kundërmësimëse e mësimëse.

Në dallim nga shtabet e përgjithshme të vendeve të tjera, Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacional-Çlirimtare u krijua si organ i zgjedhur, jo i emëruar, çka përbënte një veçori shumë domethënëse. Në mbledhjen e parë themeluese të Shtabit të Përgjithshëm, Enver Hoxha theksonte se “Shtabi udhëheqës i Luftës Nacional-Çlirimtare ka kompetencë të plotë ta bëjë luftën, ta zhvillojë, ta organizojë dhe të udhëheqë në

bashkëpunim me Këshillin e Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar”. Po në këtë mbledhje, major Spiro Moisiu shprehej se “Shtabi është si qendër organizative, mobilizimi, transporti e finance... qendër politike për edukimin e popullit me moralin e luftës... qendër operative, lidhje hierarkie me komandat më të alta dhe se Shtabi i Përgjithshëm asht i pamvarur në rrethin e kompetencave të tij, asht siç asht shënue më naltë”.

Shtabi Përgjithshëm përbëhej nga 12 anëtarë. Në dallim nga shtabet e përgjithshme klasike, të cilët, si rregull, përbëhen vetëm nga anëtarë shtabi ushtarakë ekspertë për linja të veçanta (zbulimi, operacionet, stërvitja, logjistika, e të tjera), në përbërje të Shtabit të Përgjithshëm u zgjodhën politikanë, intelektualë, komandantë të zotë, si dhe ushtarakë të ushtrisë shqiptare të kohës së

Mbretërisë Shqiptare, të shquar në luftë kundër pushtuesve fashistë.

Në 5 korrik 1943, anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm zgjodhën Komandantin dhe Komisarin e Shtabit të Përgjithshëm, si dhe miratuan kompetencat, strukturën organizative dhe përgjegjësitë në hierarkinë e tij. Pavarësisht se anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm ishin të gjithë të pranishëm në mbledhjen e parë themeluese, në vijim ata do të vepronin vetëm në terren, duke ndihmuar dhe kontrolluar komandat e reparteve e njëjësive partizane në fushën e luftës për zbatimin e urdhrave dhe vendimeve të Shtabit të Përgjithshëm. Anëtarëve të Shtabit që vepronin në terren, iu deleguan të drejta dhe përgjegjësi të tilla që, në situata veçanta luftarake dhe kur mungonte ndërlidhja me eprorët, të kishin të drejtë të urdhëronin në emër të Shtabit të Përgjithshëm. Me këtë organizim dhe mënyrë veprimi, si dhe duke patur në krye komandant dhe komisar, Shtabi i Përgjithshëm, përbënte, në fakt, Komandën e Përgjithshme.

Në mbështetje të këtij konceptimi, një pjesë e anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm ishin caktuar edhe në detyra komandimi e drejtimi në repartet e ushtrisë partizane nacional-çlirimtare. Por, pavarësisht nga vendi ku shërbenin, anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm, në çdo rast, ishin këshilltarë për Komandën e Përgjithshme, së cilës i raportonin situatat luftarake në zonën ku vepronin, bënin analiza për zhvillimet në terren dhe propozonin rekomandime për përdorimin luftarak të reparteve partizane, marrjen e vendimeve luftarake, si dhe bashkëveprimin mes njëjësive partizane dhe forcave vullnetare në zonën ku ndodheshin.

Është kjo arsyeja që, në periudhën nga krijimi i Shtabit të Përgjithshëm, më 10 Korrik 1943, e deri në Kongresin e Përmetit më 24 Maj 1944, në organikën e





Shtabit të Përgjithshëm dhe të shtabeve të njërive partizane, nuk u vendos funksioni “Shef Shtabi”. Kjo ishte periudha kohore më kritike e gjithë Luftës Nacional-Çlirimtare, prandaj forma e organizimit të Shtabit të Përgjithshëm si Komandë e Përgjithshme u përzgjodh dhe u vërtetua të ishte më efektive. Kjo formë e bënte hierarkinë ushtarake më të konsoliduar, mundësonte njohjen më të mirë të zhvillimeve në terren, shpejtësinë në marrjen e vendimeve luftarake dhe operativitet më efektiv komandimi e drejtimi.

Por, krahas organizimit të Shtabit të Përgjithshëm si Komandë e Përgjithshme, struktura e Shtabit të Përgjithshëm u mbush edhe me struktura ndihmëse, të përbëra nga ekspertë për armë e shërbime të veçanta, si: zbulimi, operacionet, stërvitja, logjistika, e të tjera. Këta ekspertë shërbyen si këshilltarë dhe ndihmës të drejtpërdrejtë për Komandën e Shtabit të Përgjithshëm, për formulimin e urdhrave dhe vendimeve të tij luftarakë, si dhe për transmetimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre në terren. Strukturat ndihmëse përbëheshin nga Shtabi Operativ, Komisariati Politik, Komisariati Ekonomik, Sektori i Brendshëm dhe Sektori i Shëndetësisë.

Këto forma organizimi, komandimi dhe drejtimi të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, u vërtetuan të ishin frutdhënëse për përballimin me kosto sa më të vogël të situatave të ndërlikuara dhe të papriturave të luftës, për rritjen iniciativës në kryerjen e manovrës së forcave dhe të efektivitetit goditës kundër formacioneve të mëdha të ushtrisë naziste. Brenda kësaj fryme, Komanda dhe Shtabi i Përgjithshëm, në disa raste krijuan edhe shtabe operative të përkohshme, të cilat ngarkoheshin të drejtonin grupime forcash partizane, për të arritur objektiva taktike dhe / ose operative në një hapësirë dhe kohë të kufizuar.

Në Kongresin e Përmetit, më 24 maj 1944, në bazë të analizës gjeostrategjike të stadit të luftës në Shqipëri, të faktorëve të jashtëm, sukseseve të Forcave Aleate dhe disfatave të pushtuesve gjermanë, u morën vendime edhe me natyrë ushtarake. Këto i diktonte si karakteri i ashpër që kishte marrë lufta partizane, ashtu edhe nevojja e realizimit të objektivit përfundimtar strategjik, çlirimi i plotë i vendit nga pushtuesit. Ky realitet i ri operativo-strategjik kërkonte një hierarki e disiplinë të fortë komandimi e drejtimi. Mësymja e Përgjithshme për çlirimin e plotë të vendit shtroi nevojën e transformimit të ushtrisë partizane nga formacione të vogla taktike, në ushtri të rregullt me formacione të mëdha operative të nivelit divizion e korparmatë. Vetëm me këto nivele organizimi

e drejtimi mund të kryhej bashkërendimi, bashkëveprimi dhe manovra e thellë nga njëri front i luftës në tjetrin. Pa këto nivele, nuk mund të kishte efektivitet në betejat që priteshin për çlirimin e plotë të vendit.

Ndër vendimet me karakter ushtarak që u morën në Kongresin e Përmetit, ishte edhe riorganizimi i Shtabit të Përgjithshëm, si dhe vendosja e gradave ushtarake. Ndryshe nga më parë, kur në krye të Shtabit të Përgjithshëm, pra, në komandë ishin së bashku komandanti dhe komisar, në Kongresin e Përmetit u identifikuan më vete posti i Komandantit të Përgjithshëm, me gradën “Gjeneral Kolonel” dhe posti i Shefit të Shtatmadhorisë, me gradën “Gjeneral Major”. Këtë riorganizim të hierarkisë ushtarake e diktonte nevojja për një centralizëm më të fortë komandimi e drejtimi në kushtet kur lufta po bëhej gjithnjë e më e ashpër dhe me synime vendimtare për çlirimin e plotë të vendit, si dhe nevojja për të patur një lloj simetrie në bashkëveprimin dhe bashkërendimin me ushtritë e vendeve aleate.



Objekti i punës që kryente Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacional-Çlirimtare përfshinte urdhra operacionalë, organizime ushtarake në përjasje me taktikat dhe strategjinë që kërkonte koha, përgatitjen e personelit drejtues dhe stërvitjen e luftëtarëve në kushtet e luftës, sigurimin e armatimit, logjistikës, etj. Urdhrat operacionalë nuk diktonin dhe as kufizonin komandat e shtabet

në vendimmarrjen e tyre.

Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, i krijuar në luftë e sipër, nuk trashëgoi asnjë vijimësi organizative nga shteti shqiptar i paraluftës. Ai Shtab, i ideuar njëherësh edhe si Komandë e Përgjithshme, organizoi, komandoi dhe drejtoi Ushtrinë Nacional-Çlirimtare dhe strukturat e tjera të mbrojtjes popullore territoriale për arritjen e objektivit më të lartë strategjik të kohës: çlirimin e plotë të vendit nga pushtuesit fashistë e nazistë. Nën drejtimin dhe komandimin e atij Shtabi, Ushtria Nacional-Çlirimtare arriti të ishte në gjendje të shpërthente ofensivë të vetën dhe, në të njëjtën kohë, të përballonte ofensivën e forcave gjermane. Hierarkia serioze, formacionet e mëdha taktiko-operative dhe lëvizshmëria strategjike në tërë territorin e vendit e jashtë kufijve të tij, i dhanë asaj ushtrie mundësinë të ndërmernte angazhime luftarake të suksesshme ndaj formacioneve të mëdha, të mirë organizuara dhe të mirë armatapura gjermane e italiane dhe të

i efektivitetit të këtij organizimi, të provuara në Luftën më të Madhe Botërore. Shndërrimi i Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, menjëherë pas çlirimit të vendit, në forcë të armatosur për mbrojtjen e vendit, ishte investimi vijues strategjik i Shtabit të Përgjithshëm për të ardhmen shtet-ndërtuese të vendit, në kushtet kur Shqipëria nuk trashëgoi asnjë organizim dhe asnjë infrastrukturë nga shteti i paraluftës.

Shtatmadhoria (më vonë “Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Popullore”) të krijuara menjëherë pas përfundimit të Luftës Nacional-Çlirimtare, mbi bazën e përvojës unike të komandimit dhe drejtimit të një ushtrie që bëri dhe fitoi luftën më të madhe që ka kryer populli shqiptar që nga krijimi i shtetit shqiptar, si dhe mbi bazën e arsimimeve e të kulturës ushtarake të përfituara jashtë dhe brenda vendit, drejtoi për 45 vjet, ushtrinë më të madhe që ka mobilizuar ndonjëherë Shqipëria në pikëpamje të numrit, më të plotën në pikëpamje të strukturës e të organizimit, më të mirë armatosurën, më të mirë pajisurën dhe më të mirë stërviturën në pikëpamje të kualiteteve.

Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura në qeverisjen e pas vitit 1991 u strukturua plotësisht sipas modeleve të shtabeve të përgjithshme të vendeve anëtare të NATO-s dhe drejtoi e drejton këto forca për sigurimin e pavarësisë së vendit, mbrojtjen e tërësisë territoriale, rendit kushtetues dhe detyrimeve e angazhimeve në kuadër të Aleancës Euro-Atlantike.

Por, pas vitit 1991, përveçse data 10 korrik u hoq nga kalendari i festave shtetërore, është zbehur edhe përkujtimi, vlerësimi, studimet institucionale dhe pasqyrimi real i saj në faqet zyrtare, i veprimtarisë dhe kontributit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare. Kësisoj, u vu në pikëpyetje vlera e një date unike për llojin e vet në historinë e Shqipërisë, duke cenuar një kërkesë themelore e identitetit kombëtar, institucional, kulturor dhe ushtarak: ruajtjen e raportit me historinë. Kështu siç është vepruar, iu është dhënë udhë paragjykimeve, shijeve apo frikërave personale, të cilat prirën ta përmbysin këtë raport dhe të tjetërsojnë vlerat që përfaqëson.

10 Korriku ka arsye historike dhe institucionale të evokohet e të përkujtohet, si në kuptimin që shteti shqiptar nuk i ka munguar kultura për të

dilte fitimtare në atë luftë.

Në mbarim të Luftës së Dytë Botërore, Ushtria Nacional-Çlirimtare përbëhej nga 3 korparmata, 8 divizione dhe 24 brigada sulmuese, me një efektiv të përgjithshëm prej rreth 70 000 luftëtarësh. Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, njëherësh Komandë e Përgjithshme, ishte stadi më i lartë i organizimit ushtarak dhe

ngritur institucione të tilla të nivelit strategjik ushtarak, ashtu edhe për t'i dhënë vendin që i takon Shtabit të Përgjithshëm të krijuar në atë datë, si i vetmi shtab i përgjithshëm në historinë e Shqipërisë, i cili organizoi e drejtoi luftë dhe e fitoi atë, në bashkëveprim e në bashkërendim me shtabet e tjera të Aleancës së Madhe Antifashiste e Antinaziste.

Gruaja është më e fortë se burri, sepse në të njëjtën kohë mban gjallë dy krijesa, veten dhe fëmijën. Gruaja është shtylla e shtëpisë. Natyrisht, por nuk duhet eliminuar burri, sepse ai mban shtyllën.

Shpesh ndodh te ne, por edhe në botë, një femre që i dëgjohet zëri, përkufizohet si një femër e fortë. Për hir të dhunës që ushtrohet mbi të, për ofendimet që gruaja i pranon, për trupin që ia shfrytëzojnë, për inteligjencën e përbuzur, njollosur, konsideruar si objekt talljeje dhe turp i dhimbshëm, kufizimet, lirinë e cenuar, gojën që shpesh gruas ia mbyllim, atëherë si duhet vepruar nga ana e mashkullit, kur i dëgjon të gjitha këto që i bëhen një gruaje.

“T’i bie në gjunjë”, thotë William Shakespeare. Nuk bën as t’i të përbuzesh nga gruaja, por as ta ofendosh gruan. Gruaja nuk kërkon që mashkulli t’i bjerë në gjunjë, por ta kuptojë lodhjen e saj, e cila e ka bërë të fortë, mendimet e bluara në vete që asnjëherë nuk kishte të drejtë t’i nxirrte nga goja. Gratë janë lodhur nga lotët e buzëqeshjeve të maskuara, me shpresë se dikush do ta kuptojë dhimbjen e tyre, këtë lodhje mund ta kuptojë vetëm ai që arrin të ndjehet njëjtë.

Edhe Friedrich Nietzsche, filozof gjerman e pranon se gruaja njih vetëm dashurinë. Por, në cilin kontekst? Ky filozof i zhgënjyer nga një grua dhe i revoltuar shkruan: “Për një kohë shumë të gjatë u fshehën tek gruaja skllavi dhe tirani. Prandaj akoma gruaja s’është e aftë për miqësi”.

Ndonëse gruaja e zbuti skllavin dhe tiranin sipas Nietzsches me fshehjen e saj, duke mos lënë vend për miqësi. Sa pak u përpoq ta njihte gruan, sepse gruaja është forca, inteligjenca, dashuria, urrejtja, jetëdhënësja, por dhe ajo që syri s’iu tremb kurrë nga rreziku që i kanoset.

Kapedania arvanitase Laskalina (emri i vërtetë Dhaskalina) Bubulina. ishte 50 vjeçe kur shpërtheu revolucioni grek, dhe u bë pjesë e luftës për lirinë e atdheut të të parëve të saj. Nuk numërohen betejat që ajo i drejtoi me trimëri. Në njërrën prej tyre ra heroikisht edhe djali i saj Jani. Me emrin dhe trimërinë e saj ngriti më këmbë 200 mijë arbëreshë kundër pushtuesve osmanë, u bë shembull heroizmi, u kthye në një legjendë të pavdekshme, në një figurë hyjnore që e lartëson historinë e popullit tonë.

Dhaskalina Pinoti Bubulina, ishte komandante e anijes luftarake “Agamemnon”, me të cilën i dha ndihmë të madhe Ali Pashë Tepelenës, kur Janinën e rrethuan turqit. Ajo iu kushtua çështjes së çlirimit të kombit grek duke dhënë përveç ndihmës së saj heroike, edhe pasurinë e madhe trashëguar nga bashkëshorti.

Është e vetmja grua në histori që iu dha titulli i madh “Gruaja e Parë Admirale” nga perandori rus. Këtë grua trimëreshë e gjen të përshkruar me gjithë madhështinë e saj tek poeti arbëresh Zef Serembe, Zhyl Verni, tek historiani grek Kosta Biri, Michael Kokkinaris etj. Ajo tashmë është një legjendë nga gojëdhënat, poezia popullore, ka hyrë në pikturë, skulpturë, mbetet e tillë si në Greqi dhe Shqipëri.

Edhe pse kishin kaluar shekuj, që në kohën kur stërgjyshërit e saj kishin lënë Arbërinë, Bubulina nuk e harroi atdheun e saj të dashur. Historianët dhe biografët e saj thonë se Bubulina u jepte urdhra detarëve të saj trima nëpër beteja vetëm në gjuhën shqipe. Ishte kjo gjuhë që i ngriti në këmbë fshatarët arbëreshë të Buas, të Spatës, të Lalës, të Laskës, Lopësit, Muzaqit.

Bubulina do pësonte vdekjen nga dora e një arvanitasi (familja Koçi), si pasojë e një armiqësie familjare.

Në ishullin Peca gjendet “Muzeu Bubulina” vendosur në ndërtesën 300-vjeçare të burrit të dytë, ku ende jetojnë pasardhësit e saj. Statuja e saj qëndron në port në Pecës. Rrugë të ndryshme në të gjithë Greqinë dhe Qipron janë emëruar për nder të saj.

"Grua nuk lind, por bëhesh!"



Historia ka listuar emra të grave që qëndruan dhe luftuan për të tejçuar zërin përmes shkrimeve të forta dhe punëve që u shndërruan në himn për brezat e rinj.

SIMONE DE BEAUVOIR (Revolucion në Feminizëm)

“Çfarë do të thotë të jesh grua?” Përgjigjja, e cila u shndërrua në britmën e luftës së feminizmit anëmbanë botës, u përmbodh nga Simone de Beauvoir në një fjali: “Grua nuk lind, por bëhesh!”. Në kontrast të fortë me traditën filozofike një mijëvjeçare, De Beauvoir shembi idenë se bindja, besnikëria dhe heshtja ishin virtyte tipike femërore.

MARTHA GRAHAM (Revolucion në Kërcimin Modern)

Martha Graham e interpretoi shekullin XX, dy luftërat botërore, feminizmin dhe psikanalizën, duke kërcyer me furi. Graham ishte themeluesja e kërcimit modern dhe pioniere e gjithë manifestimit të tij novator në Perëndim. “Gratë, - thoshte ajo, - nuk kanë nevojë të zhvishen për të qenë sensuale, kurse burrat, po”.

VIRGINIA WOOLF (Revolucion në Shkrim)

“E kush arrin që të masë zjarrin dhe dhunën e zemrës së poetit, kur zihet e mbërthehet në trupin e një gruaje?”. Virginia dëshironte të përfshihej në një botë që u përkiste vetëm burrave romancierë dhe ia doli mbanë. Strukturën tradicionale të romanit e zbërtheu copash, dhe në të shtoi materiale për t’u kujtuar grave rrënjët e luftës së tyre për pavarësi... “Gruaja duhet të ketë para dhe një dhomë më vete, nëse dëshiron të shkruajë romane”.

AMELIA EARHART (Zonja e Qiejve)

Amelia Earhart ishte karizmatike, plot kurajë dhe guximtare. Jeta dhe vdekja e saj u bënë legjendare, sa edhe sot njerëzit vazhdojnë të kërkojnë mbetjet e avionit të saj, i cili u zhduk në mënyrë të mistershme teksa fluturonte mbi Oqeanin Paqësor, në vitin 1937. “Gratë, ashtu

sikurse burrat, duhet të përpiqen të realizojnë të pamundurën. Dhe kur nuk ia arrijnë, dështimi i tyre duhet të jetë sfidë për gratë e tjera.”

MARIA MONTESSORI (Revolucion në Pedagogji)

Maria Montessori bëri revolucion në pedagogji, duke i vendosur fëmijët, krijimtarinë mendore dhe individualitetin e tyre në qendër të gjithçkaje. “Shenja më e madhe e suksesit për një mësues është që të thotë: Fëmijët po punojnë sikur unë të mos ekzistoj”. Në këtë mënyrë, ajo ndoqi ëndrrën për një shoqëri të përbërë nga njerëz që do të ishin të çliruar edhe të pavarur nga fëmijëria e tyre dhe, kësisoj, të aftë për t’u bërë mendimtarë kritikë dhe persona për t’u dalë zot ekzistencës së tyre. “Është folur shumë për të drejtat e njeriut, sidomos për të drejtat e punëtorëve, po çka ardhur çasti të flitet për të drejtat shoqërore të fëmijëve”.

RITA LEVI-MONTALCINI (Revolucion në Mjekësi)

Rita Levi-Montalcini filloi të nuhaste se njeriu nis nga një qelizë e vetme, por me kohën bëhet një organizëm i dhjetëra indeve të ndryshme. Në vitin 1986, asaj iu dha çmimi “Nobel” për mjekësinë. Montalcini, një feministe e vendosur, thoshte: “Të gjithë thonë se truri është organi më i ndërlikuar i trupit të njeriut. Si mjeke, mund edhe të bie dakord. Por, si grua, ju siguroj që nuk ka asgjë më të ndërlikuar se zemra. Mekanizmat e saj ende nuk njihen sot.”

ROSA PARKS (Revolucion nga ndenjësja e autobusit)

“Duke qëndruar ulur, ajo u ngrit për të mbrojtur të drejtat e të gjithëve dhe dinjitetin e Amerikës”, deklaroi presidenti Bill Clinton, kuj po i jepte Medaljen e Artë të Kongresit rrobaqepëses nga Alabama që nisi një revolucion nga ndenjësja e autobusit. Rosa frymëzoi krijimin e librave, këngëve dhe filmave, ndërsa 1 dhjetori u shndërrua në datën simbolike të luftës ndaj racizmit dhe diskriminimit. “Do të doja të njihesha si një grua

që është e shqetësuar për lirinë, barazinë dhe mirëqenien e të gjithë njerëzve”.

MARGARET THATCHER (Revolucion në Politikë)

Ajo e kaloi jetën në vijë të parë të frontit, gjithmonë besnike ndaj nofkës së saj “Zonja e Hekurt”. Margaret Thatcher e qeverisi Mbretërinë e Bashkuar nga viti 1979 deri në 1990-n me strategjinë e saj pragmatiste: “Në politikë, nëse dëshiron që të thuhet diçka, kërkoja një burri. Nëse dëshiron që të bëhet, kërkoja një gruaje”. Politika ishte jeta e saj dhe parlamenti ishte vendbanimi. Ajo ka thënë: “Fuqi do të thotë të jesh zonjë. Nëse je e detyruar t’ua tregosh të tjerëve këtë, s’mund të jesh e tillë.”

MALALA YOUSAFZAI (Revolucion në Arsimit)

A mundet një vajzë e re që ta ndryshojë botën? Malala Yousafzai e bëri kur ishte pothuajse fëmijë, duke u shndërruar në simbolin e luftës për të drejtat e studimit për të gjithë fëmijët në mbarë botën. Tek fliste në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, Malala e dinte që talebanët ishin betuar për t’u hakmarrë: “Ata i tremb fuqia e arsimit. Kanë frikë nga gratë. Kjo është arsyeja pse vrasin, pasi kanë frikë” . Kuraja e saj u shpërblye me çmimin “Nobel” për Paqen, në vitin 2014, kur Malala ishte vetëm shtatëmbëdhjetë vjeçe. “U kërkoj udhëheqësve të botës që të investojnë në libra dhe jo në plumba”.

RACHEL CARSON (Revolucion në Biologji)

Me botimin e librit “Pranverë e heshtur” RACHEL i dha shkëndijë lindjes së lëvizjes ambientaliste. Autorja ishte shkencëtare e pasionuar dhe shkrimtare elegante, e cila arriti të mrekullonte botën me fuqinë e prozës së saj. Rachel deklaroi: “Më shumë se kurrë më parë, raca njerëzore është sfiduar që të tregojë aftësinë e saj, jo duke u marrë me natyrën, por me veten tonë”.

ÇELIK TALUSHLLARI - MONUMENTI MBI VALË DETI

Në 75-vjetorin e rënies



KAPITEN (P) VERI TALUSHLLARI

Me gjithë moshën e thyer, tek të 80-at, çdo 5 Maj dhe 10 Korrik, Lylyvera Talushllari Stërmolli ngjitet ngadalë në Varrezat e Dëshmorëve në Korçë për të vënë një tufë lulesh në një varr bosh. Një varr që ka 75 vjet që pret eshtrat e një djaloshi 20-vjeçar, e që me siguri do të mbeten aty ku janë, monument mbi valë deti. Ajo ishte vetëm 5 vjeç kur heroi i saj, xhaxhai i saj, - dhe i autorit të këtij shkrimi, saktësisht kushëriri i parë i baballarëve tanë, - Çeliku, u vra tradhtisht dhe u hodh në thellësitë e Adriatikut, në një përpjekje heroike për kryerjen e detyrës dhe mbrojtjen e pasurisë kombëtare.

Ishte nata e 9 korrikut 1948. Lylyvera e mban mend fare pak, sa mund të mbajë mend një fëmijë pesëvjeçar, të gjatë e të bukur, me uniformën e marinarit, kur erdhi për herë të fundit me leje për të takuar prindërit, familjarët dhe nusen e tij të re. Kur dëgjoj atë këngën “Vajza e Valëve”, gjithnjë e kujtoj nusen e tij tek rrinte në dritare me sytë nga rruga. Mbaj mend që luante me flokët e mi dhe m’i lidhte me të shoqes time e thoshte do t’u bëj pendë të lëroni arat. E ne qeshnim.

“S” më hiqet nga sytë, - thotë - ishte aq i mirë e i dashur”.

Shtëpia e Talushllarëve në Zerec të Oparit, Korçë, është një kullë tipike malësie e viteve 1800-1900, me mure të trashë guri, dykatëshe, me çati me pllaka guri. Por e ndërtuar në vitet 1930, vëllezërit, Mersini e Mehmeti, futën elementë modernë e artistikë që nga porta e hyrjes, shkallët, në odat e shumta për miq, fjetje e gatim, i bënë ato me hapësirë dhe dritë. Binte në sy, dhe bie dhe sot, pas gati 100 vjetësh, oda e madhe e miqve, me derën me dru lisi të gdhendur e atë bojën e kuqe të ndritshme, me oxhakun me gurë të gdhendur e plot zbukurime, me tre dritare që drita e mbushte nga mëngjesi në prag-mbrëmje, e mbi të gjitha tavani, një vepër e vërtetë artistike, ku edhe sot lexohet emri i mjeshtrit Ligor që e punoi si një ndërthurje rrathësh, rozetash, kuadratesh e figurash të tjera gjeometrike, të gdhendura e të ngjyrosura plot



shije dhe finesë, me bojëra speciale të blera, siç thoshin, në Selanik. Përveç 13 djem e vajza të Cines e Metes, siç u thërrisnin në fshat, në të u rritëm ne, breza të tërë pasardhësish. Ajo shtëpi është edhe pjesë e Historisë së Luftës NÇ, pasi ka qenë bazë e rëndësishme e saj, ka qenë Vendqëndrimi i Shtabit të Br1S të UNÇ dhe e Divizionit të Parë të saj si dhe i Spitalit të tyre.

Një nga betejat më të lavdishme e të ashpra të LNÇ në Operacionin e Qershorit, Lufta e Qafës së Gjarprit dhe Gurit të Prerë, Mehmet Shehu e ka drejtuar nga ajo shtëpi. E gjithë familja jonë ka qenë pjesëmarrëse aktive në Luftë, dikush partizan, të tjerët ndihmonin me e si mundeshin, deri te gratë që gatuanin e lanin rrobat e partizanëve. Vetë Çeliku dhe Hajriu, babai im, atëherë djem 15-16-vjeçarë, kanë shërbyer si korrierë të Shtabit, duke çuar letra e porosi aty ku i dërgonin.

Ja, në atë shtëpi, në vitin 1928 u lind e u rrit Çelik Mehmet Talushllari, i madhi i gjashtë djemve, i cili në moshën më të bukur, në lulen e rinisë, do të shkruante një faqe lavdie e heroizmi për mbrojtjen e Atdheut dhe të pasurisë kombëtare. Sigurisht, veprimi i tij, akti sublim i tij, vetëmohimi i tij, nuk ishte as i rastit, as i

papritur. Dhe le të mos flasim për politizim të këtij heroizmi, as të akteve si ky, të dëshmorëve dhe heronjve të Kombit që politizohen pa të drejtë, pasi bëhet fjalë për vitin 1948, vetëm tre vjet e ca pas çlirimit të vendit nga nazifashistët, kur situata politike ishte e rëndë dhe e paqartë. Prandaj e çmojmë aktin e Çelikut dhe dëshmorit tjetër që e dha jetën bashkë me të, Isuf Galiçiq, si një akt heroizmi të pastër atdhetar, akt besnikërie ndaj nderit, familjes, Atdheut, detyrës, Armës së FLD, Betimit Ushtarak.

Meqë në këtë shkrim ne do t’i referohemi me respekt e mirënjohje shkrimtarit ushtarak Resul Bedo, për dëshminë e tij të pavdekshme në serinë e librave “Heronj të Heshtur”, mendojmë se edhe ato pak fjalë për kryerjen e detyrës ndaj partisë, janë disi jashtë kontekstit. Por kjo nuk e ul vlerën e shkrimit të tij, një dëshmi e hollësishme e atij akti, që edhe sot, pas 75 vjetësh na bën krenarë dhe të bindur të themi se gjaku i derdhur për Atdhe nuk zhbëhet, nuk humbet. Dekadat, shekujt, kohërat, vetëm e bëjnë më të çmuar.

Në historikun e shkruar nga Pedagogu i Detarisë në Akademinë e Marinës dhe më pas në Universitetin “Ismail Qemali”, z. Seit Jonuzaj dhe shoku im i rinisë edhe sot e kësaj dite, kapiten Neki Lameborshi, “Detaria Shqiptare në Rrjedhën e Kohës”, ngjarja tragjike dhe heroike e datës 8-9 korrik 1948, që ka nevojë për dy saktësime: aty thuhet që ka ndodhur më 1947, e pra ka ndodhur një vit më vonë, më 1948, dhe mbiemri i Çelikut është shënuar “Hoxha”, një mbiemër që gjyshërit tanë e kanë mbajtur për pak kohë, e si duket në regjistrat ushtarakë ashtu ka mbetur, por në fakt, që përpara viteve të Luftës ata kishin për mbiemër emrin e gjyshit të tyre, Talushit, e sipas traditës së zonës, i shtuan pjesëzën “-llari”, pra në këtë historik kjo ngjarje përshkruhet pas dy heroizmave që edhe sot, pas 80-90 vjetësh janë kurorë lavdie të Flotës sonë Luftarake Detare, aktit heroik të Mujo Ulqinakut, më 7 prill1939, dhe atij të Spiro Kotes më 1 qershor 1947.

Duke mos dashur ta kopjojmë fjalë për fjalë tregimin e Muhametit, dëshmitarit të ngjarjes, që Resul Bedo na e sjell plot vërtetësi e gjallëri në V.3 të veprës së tij të çmuar dokumentare, po i themi lexuesit tonë se e gjithë ngjarja u zhvillua si në një ëndërr të tmerrshme, ku e mira dhe e

keqja, besnikëria ndaj Atdheut dhe tradhtia ndaj tij, u ndeshën me të gjithë forcën.

Katër nga pesë anëtarët e anijes së peshkimit kishin komplotuar për t’u arratisur, ndërsa njëri prej tyre, Muhameti, dhe dy ushtarakët, Çeliku pasi u thirr nën armë në radhët e FLD-s, u dërgua për kualifikim në Dubrovnik dhe u gradua kapter dhe Isufi, nuk mund ta pranonin tradhtinë. Dhe ata luftuan trimërisht gjer në frymën e fundit për mbrojtjen e atij copëz Atdheu sa madhësia e anijes. Kriminelët, të parin vranë Isuf Galiçiqin, djaloshin 21-vjeçar, kryemotorist anijeje. E vranë dhe e hodhën në det për të humbur çdo gjurmë, për të fshehur krimin e tyre. Me shpresë se Çeliku, duke parë që kish mbetur i vetëm, pasi edhe Muhameti dergjej i plagosur, do t’u bashkohej në rrugën e tyre të tradhtisë. Por gabuan. Çeliku u përlesh me ta me gjithçka munda, me armë e me grushte, e, megjithëse i fortë e i fuqishëm, i vetëm përballë tre egërsirave që u munduan ta hidhnin në det edhe atë, u kap pas litarëve dhe gomave të shpëtimit. Por ata, të pamëshirshëm siç ishin, ngritën sëpatën dhe i prenë duart e ai farë trimi 20-vjeçar i sapomartuar e me aq shumë ëndrra e plane për të ardhmen, përfundoi në det. Kriminelët menduan se nuk mbeti asnjë gjurmë nga akti i tyre i përbindshëm, por për tmerrin e tyre, motori i anijes pushoi së punuari dhe era e ktheu anijen mbrapsht, në brigjet nga ishte nisur, në grykën e Semanit.

Tre kriminelët e kërcënuan detarin Muhamet, që të mos tregonte ç’ ndodhi, por ai dëshmoi gjithë këtë ngjarje sa tragjike aq heroike, duke çuar para gjyqit të popullit kriminelët dhe në altarin e lavdisë e të nderit Dëshmorët e Atdheut Çelik Talushllari dhe Isuf Galiçiq. Ndërsa anija, e tërhequr nga një motovedetë ushtarake, mbërriti në portin e



Durrësit në agimin e 10 korrikut, në Tiranë fillonte Parada e 5-vjetorit të Ushtrisë sonë Kombëtare. Në krye të kuadratis të Flotës sonë Luftarake Detare parakalonte Heroi i Popullit Spiro Kote, i cili bashkë me shokët e tij nderonin edhe aktin heroik të dy bashkëluftëtarëve të tyre, gjaku i të cilëve ende skuqte sipërfaqen e Adriatikut.

E sot, pas 75-vjetësh, akti i Çelik Talushllarit dhe Isuf Galiçiqit, aktet heroike të Dëshmorëve të Kombit, në luftërat për liri, pavarësi e mbrojtje të Atdheut, nga thellësia e shekujve, dekadave e deri në ditët që ne i kemi përjetuar, si ato të Adem Jasharit, Ymer Helshanit e Antigona Fazllit e familjeve të tyre, e sa e sa djem e vajza që mbetën në kujtesën e Kombit po aq të rinj sa ditën kur u flijuan për Atdhe e për Flamur, kujtohen me nderimin më të madh. E kështu do të kujtohen në dekadat e shekujt që vijnë.



Qendra Ndërkombëtare për Ndjekjen e Krimit të Agresionit kundër Ukrainës fillon operacionet në Eurojust

Duke shënuar një moment historik, Qendra Ndërkombëtare për Ndjekjen e Krimit të Agresionit kundër Ukrainës (ICPA) nisi zyrtarisht punën në Eurojust. ICPA do të mbështesë përgatitjen e rasteve të krimit të agresionit, duke siguruar prova thelbësore dhe duke lehtësuar procesin e ndërtimit të rasteve në një fazë të hershme.

Në një ngjarje të dedikuar nisjes, në ambientet e Eurojust-it në Hagë, ICPA u përurua nga Presidenti i Eurojust-it Ladislav Hamran, Komisioneri Evropian për Drejtësinë Didier Reynders, Prokurori i Përgjithshëm i Ukrainës Andriy Kostin, Prokurori i ICC-së Karim A.A. Khan, Ndihmës Prokurori i Përgjithshëm Kenneth A. Polite dhe Ministri e Drejtësisë e Holandës znj. Dilan Yeşilgöz-Zegerius. Në të njëjtën kohë, u nënshkrua një marrëveshje kontributi me Shërbimin për Instrumentet e Politikës së Jashtme të Komisionit Evropian dhe u zhvillua takimi i parë operativ fillestar i Qendrës.

Gjatë ngjarjes së nisjes, Komisioneri Evropian për Drejtësinë Didier Reynders tha: Me krijimin e ICPA-së, Bashkimi Evropian përsërit angazhimin e tij për të siguruar përgjegjësi të plotë për krimet ndërkombëtare të kryera gjatë luftës së Rusisë kundër Ukrainës, përfshirë krimin e agresionit. Krijimi i ICPA-së është një sinjal i qartë për botën se ndalimi i përdorimit të forcës vazhdon të jetë themeli i rendit tonë ndërkombëtar të bazuar në rregulla dhe se ata që e shkelin atë do të mbahen përgjegjës.

Presidenti i Eurojust-it Ladislav Hamran deklaroi: “Eurojust ka krijuar një histori solide në ofrimin e mbështetjes operative, teknike, logjistike dhe financiare për prokurorët kombëtarë që punojnë në rastet ndërkufitare. Që nga fillimi i kësaj lufte, e njëjta mbështetje ka shërbyer për të koordinuar dhe forcuar hetimet kombëtare për krimet ndërkombëtare të kryera në Ukrainë. ICPA përfaqëson një hap tjetër thelbësor në përpjekjet tona kolektive për t’i dhënë fund mosndëshkimit në të gjitha nivelet”.

Prokurori i Përgjithshëm i Ukrainës Andriy Kostin vuri në dukje: “Fillimi zyrtar i Qendrës Ndërkombëtare për Ndjekjen e Krimit të Agresionit është një sinjal i qartë se bota është e bashkuar dhe e palëkundur në rrugën për ta mbajtur regjimin rus përgjegjës për të gjitha krimet e tij. Për fat të keq, ka një vrimë të hapur në përgjegjësinë për krimin e agresionit në arkitekturën ndërkombëtare të drejtësisë penale. ICPA është një nga blloqet ndërtuese të forcimit të ndalimit të agresionit, duke plotësuar dhe forcuar kështu këtë arkitekturë”.

Karim A.A. Khan, Prokurori i Gjykatës Ndërkombëtare Penale komentoi: “Nga errësira dhe vuajtja e vërtetë që kemi parë në të gjithë Ukrainën, ne kemi parë gjithashtu të dalë dritë në ndërtimin e partneriteteve të reja drejt llogaridhënies. Unë jam i qartë në mesazhin tim sot se ne mbetemi të përkushtuar për forcimin e mëtejshëm të themeleve të bashkëpunimit që kemi ndërtuar me Eurojust-in dhe autoritetet kombëtare gjatë vitit të kaluar përmes Ekipit të Përbashkët Hetimor”.

“Departamenti Amerikan i Drejtësisë është krenar që qëndron përkrah partnerëve tanë evropianë dhe është ndër të parët që ka marrë pjesë në Qendrën Ndërkombëtare për Ndjekjen e Krimit të Agresionit kundër Ukrainës (ICPA)”, - tha Ndihmës Prokurori i Përgjithshëm Kenneth A. Polite, Jr. Divizioni Penal i Departamentit të Drejtësisë. Prokurorja e posaçme e Departamentit të Drejtësisë për Krimin e Agresionit, Jessica Kim, do të përfaqësojë Shtetet e Bashkuara në ICPA dhe ajo do të ketë akses të papenguar në trupin e konsiderueshëm të ekspertizës dhe burimeve që Departamenti ka grumbulluar në përgjigje të paligjshmërisë së luftës dhe agresionit të Rusisë kundër Ukrainës.

Dilan Yeşilgöz-Zegerius, Ministër i Drejtësisë i Holandës shtoi: “Sot me hapjen e ICPA-së ne kemi ndërmarrë një hap të rëndësishëm për të siguruar që krimet ndërkombëtare që vijnë nga agresioni rus kundër Ukrainës do të ndiqen penalisht. Kjo kërkon hetime komplekse dhe ne mund të ndihmojmë njëri-tjetrin për këtë në ICPA. Për këtë arsye, Holanda është krenare që është vendi pritës i ICPA-së.

Roli i ICPA-së dhe Eurojust

ICPA është një qendër unike gjyqësore e integruar në Eurojust për të mbështetur hetimet kombëtare për krimin e agresionit në lidhje me luftën në Ukrainë. Falë ICPA-së, prokurorët e pavarur nga vende të ndryshme do të jenë në gjendje të punojnë së bashku në të njëjtin vend në baza ditore, të shkëmbejnë prova në mënyrë të shpejtë dhe efikase dhe të bien dakord për një strategji të përbashkët hetimore dhe ndjekëse. Puna e ICPA-së do të përgatisë dhe kontribuojë në mënyrë efektive në çdo ndjekje penale të ardhshme të krimit të agresionit, pavarësisht nga juridiksioni para të cilit do të sillen.

Pjesëmarrësit në ICPA do të përfitojnë nga mbështetja operative, teknike, logjistike dhe financiare e Eurojust-it. Baza e të dhënave kryesore të provave ndërkombëtare të krimeve (CICED), e

menaxhuar nga Eurojust, do të jetë qendrore për të mundësuar punën e ICPA-së. Dëshmitë e dorëzuara tashmë në CICED në kontekstin e krimeve të tjera ndërkombëtare (krimet e gjenocidit, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës) mund të jenë po aq të rëndësishme për hetimin e krimit të agresionit. Gjithashtu do të jetë e mundur të ruhen dëshmitë kombëtare në CICED të sjella nga pjesëmarrësit e ardhshëm të ICPA-së për t’u analizuar më pas.

Të qenit i vendosur në Hagë ka disa përparësi. Jo vetëm që ICPA do të ketë akses të drejtpërdrejtë në ekspertizën e vlefshme të Sekretariatit të Rrjetit të Gjenocidit të organizuar në Eurojust, por gjithashtu do të lehtësojë bashkëpunimin dhe koordinimin e ngushtë me GJNP-në dhe aktorë të tjerë ndërkombëtarë të drejtësisë.

Çfarë e bën ICPA urgjente dhe unike?

Lufta në Ukrainë është më e dokumentuara në histori dhe, për herë të parë, hetimet aktive për krimin e agresionit po zhvillohen ndërkohë që një konflikt i armatosur është ende në vazhdim. Në të njëjtën kohë, kemi të bëjmë me një krim ndërkombëtar që rrallëherë është ndjekur penalisht dhe për të cilin nuk ka asnjë praktikë standarde.

Krijimi i shpejtë i ICPA-së lidh hende kun midis ambicieve dhe realitetit, duke bashkuar palët përkatëse të interesit, duke siguruar prova thelbësore dhe duke u siguruar që të mos humbasë kohë në ndërtimin e një çështjeje për ndjekjen e ardhshme penale të krimit të agresionit. Duke vepruar kështu, komuniteti ligjor po jep një mesazh të qartë se ata që janë përgjegjës për krimin e agresionit kundër Ukrainës do të mbahen përgjegjës. Prandaj, lansimi i sotëm i ICPA-së përfaqëson një moment historik për drejtësinë ndërkombëtare.

Pjesëmarrësit në ICPA

Përveç Ukrainës, pesë nga anëtarët e ekipit të përbashkët të hetimit (JIT) (Lituania, Letonia, Estonia, Polonia dhe Rumania) po marrin pjesë në fazën fillestare të ICPA-së. ICPA gjithashtu do të përfitojë nga pjesëmarrja e ICC. Pas një Memorandumi të Mirëkuptimit me anëtarët e EPH-së, Shtetet e Bashkuara kanë emëruar një prokuror special për krimin e agresionit, i cili do të mbështesë aktivitetet e ICPA-së.

Në muajt e ardhshëm do të lehtësohet pjesëmarrja e vendeve dhe organizatave të tjera në ICPA, si Misioni Këshillimor i BE-së në Ukrainë. Vendet që zotërojnë informacion ose prova të rëndësishme për hetimin e krimit të agresionit kundër Ukrainës mund të kërkojnë gjithashtu pjesëmarrjen e tyre.

Financimi i ICPA-së

ICPA financohet plotësisht nga Shërbimi i Komisionit Evropian për Instrumentet e Politikës së Jashtme. Marrëveshja e kontributit

financiar që mbulon një shumë fillestare prej 8.3 milionë eurosh u nënshkrua sot nga Drejtori i Shërbimit për Instrumentet e Politikës së Jashtme të Komisionit Evropian, z. Peter M. Wagner, dhe Drejtori Administrativ i Eurojust, z. Evert van Walsum.

Mbështetja e përgjithshme e Eurojust-it për përpjekjet e Ukrainës për llogaridhënie

Që nga shpërthimi i luftës, Eurojust ka qenë në ballë të mbështetjes së llogaridhënies për krimet ruse, bazuar në përvijën e saj 20-vjeçare të punës me prokurorët kombëtarë në rastet ndërkufitare.

Vetëm gjashtë ditë pas fillimit të luftës, Eurojust mbështeti ngritjen e një EPH që tani përbëhet nga Ukraina, gjashtë shtete anëtare të BE-së dhe ICC. Duke njohur sfidat specifike të provave në lidhje me këtë lloj hetimi, u krijua një CICED, bazuar në një ndryshim urgjent të mandatit të Eurojust-it pas pushtimit të Ukrainës. Deri më tani, qindra dosje nga nëntë vende, duke përfshirë Ukrainën janë dorëzuar në CICED. Rezultatet e para analitike konfirmojnë përfitimet e prekshme të bazës së të dhënave për praktikën prokuroriale.

Agjencia gjithashtu pret Rrjetin e BE-së për hetimin dhe ndjekjen penale të gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës (Rrjeti i Gjenocidit), një qendër qendrore për shkëmbimin e ekspertizës në këtë fushë. Tashmë vendosja e kësaj strukture të avancuar mbështetëse e bën Eurojust-in në pozicionin më të mirë për të pritur ICPA-në. Krimi i agresionit është një krim i kryer nga lidhshipi më i lartë politik dhe ushtarak. Duke qenë se Rusia nuk është palë e Statutit të Romës, GJNP-ja aktualisht nuk mund të ndjekë penalisht udhëheqjen ruse për krimin e agresionit në kontekstin e luftës së Rusisë kundër Ukrainës.

Për të mbyllur këtë hende kun, në nëntor 2022, Komisioni Evropian dhe Shërbimi Evropian i Veprimit të Jashtëm paraqitën një dokument që analizonte opsionet e ndryshme për të siguruar përgjegjësi të plotë për krimet e kryera në kontekstin e luftës ruse kundër Ukrainës, përfshirë krimin e agresionit. ICPA është hapi i parë në këtë proces për të ruajtur provat dhe për të përgatitur çështjet për gjykimet e ardhshme, qofshin ato para gjykatave kombëtare, gjykatës së dedikuar ose Gjykatës Penale Ndërkombëtare për krimet brenda juridiksionit të saj. Presidentja e Komisionit Evropian Ursula von der Leyen njoftoi ngritjen e Qendrës Ndërkombëtare për Ndjekjen e Krimit të Agresionit kundër Ukrainës në Samitin e 24-të BE-Ukrainë më 2 shkurt 2023.



Mbrojtja Kundërajrore, "sytë tanë në qiell"

Që kur u realizua fluturimi i parë i një avioni me motor në botë, nisën edhe përpjekjet për të konstruktuar armë për kundërveprim ndaj këtij mjeti të ri luftarak. Procesi i zhvillimit të armatimit e teknikës së Mbrojtjes Kundërajrore ishte i njëkohshëm me atë të Aviacionit. Në vitin 1914 topat e artilerisë kundërajrore të prodhimit më të hershëm fillimisht u vendosën në platformat e mjeteve lundruese detare më pas në vijën bregdetare dhe në pozicione zjarri fushore në vijë të drejtë në zonën e luftimeve gjatë Luftës së Parë Botërore.

Avioni i parë armik mbi tokën shqiptare u rrëzua më 23 korrik 1920. Në luftën e Vlorës në betejat e ashpra të 23 korrikut 1920, luftëtarët shqiptarë rrëzuan një avion që fluturonte ulët dhe mitralonte pozicionet e tyre. “Abduraman Çiraku (mbështetës i Ismail Qemalit) ka dëshmuar se me sulmin e parë në Kotë, forcat italiane u shpartalluan. Atje zumë rob mbi 1300 vetë. Veç materialit tjetër ushtarak, zumë edhe 3 topa. Topat na duheshin për luftimet e mëvonshme, prandaj çeta më ngarkoi mua t’i marr në dorëzim. Bëra gati 2 topa, njërin ia dhamë çetës të Tepelenës, tjetrin e mbajta vetë e vendosa mbi Kaninë në Majë të Çuçiës tek Qafa e Pllakës. Me predhat e topave që iu kapëm armikut, fundosëm katër luftanije dhe rrëzuam një aeroplan bombardues që ranë në fushën Peshkëpisë”, - thotë Avni Skënderaj, ish-oficer i Mbrojtjes Kundërajrore.

Më 1 shtator 1928, në Tiranë u prezantuan topat e dërguar nga Italia, Musolini, për Mbretin Zog. “Në pallatin mbretëror gjëmuan topat e sjellë nga italianët të zbrazur nga ushtarët shqiptarë të veshur me uniform italiane”, kujton ish-ushtaraku Skënderaj. “Ushtria, financat, doganat, banka kombëtare, xhandarmëria, drejtoreshin nga italianët”.

Tre bateritë e para me dekret të Mbretit, më 1 korrik 1931, u përhapën në pozicione zjarri në vijën bregdetare, një bateri në Shëngjin, një në Durrës dhe një bateri në Sarandë.

Pikërisht dekreti i datës 1 korrik 1931, për përhapje në pozicione zjarri të këtyre baterive ishte edhe dokumenti ku u mbështet udhëheqja politike, shtetërore, ushtarake e Shqipërisë në vitin 1995, për rishikimin e datave zyrtare të krijimit të llojeve të armëve të ushtrisë shqiptare të reformuar në post diktaturë. Pra 1 korriku 1931 është data zyrtare e krijimit të Mbrojtjes Kundërajrore të shtetit shqiptar, por për studiuesit mbetet ende për të hulumtuar se si ka funksionuar Mbrojtja Kundërajrore në vitet e Mbretërisë.

Pas Luftës NAÇI, ushtria gjermane la në territorin shqiptar disa topa 20 mm e 25 mm. Ky armatim trofe u grumbullua u riparua dhe u vendos në pozicione zjarri që në vitin 1945. Dhe në tetor 1945 u dërguan në Bashkimin Sovjetik 12 studentë për të përgatitur oficerët e parë. Gradualisht u rrit numri i ushtarakëve të AKA, raketave, Radiolokacionit të përgatitur pas vitit 1961 vetëm në shkollat ushtarake dhe akademinë ushtarake shqiptare. U rrit sasia e armëve e teknikës luftarake dhe u organizua sistemi MKA sipas kërkesave të kohës.

Në vitin 1990, Shqipëria kishte 24 regjimente të MKA-së, 4 grupe raketash kundërajrore 72 radarë të zbulimit të largët ajror, 102 grupe AKA, 18 batalione mit KA, 380 bateri AKA, 210 kompani mit KA 14.5 mm, 570 toga mit KA 12,7 të përhapura në 1380 pozicione zjarri e vrojtimi. Gjithçka ishte për mbrojtjen e hapësirës ajrore të vendit në bashkëveprim të ngushtë me Aviacionin luftarak, Flotën luftarake detare, Forcat tokësore dhe Forcat vullnetare të vetëmbrojtjes popullore.

Brezi i parë i ushtarakëve të MKA-së i përket viteve 1945-1970, brezi i dytë viteve 1970-1995 dhe brezi i mëvonshëm ai i pas viteve 1995 e më tej. Gjenerata e parë e ushtarakëve, ka meritën historike të ngritjes nga themelet të MKA-së, rritjes në sasi e cilësi në kushtet kur vendi ishte anëtar i Traktatit të Varshavës. Gjenerata e dytë përjetoj vështirësitë e shërbimit në kushtet e



Luftës së Ftohtë dhe izolimit të vendit. Gjenerata e tretë përjetoj reformat e thella pas ndryshimeve politike të vitit 1990. Në rrethanat e reja krejt të ndryshme nga ato më parë, ushtarakët e MKA-së kryen misionin në kushtet e anëtarësimit të vendit në Aleancën Euroatlantike, NATO.

Mbrojtja Kundërajrore dhe Aviacioni, transformimi

Sipas dokumenteve arkivore, përpjekjet për krijimin e Armës së Aviacionit janë të hershme. Qeveritë e para Luftës së Dytë Botërore, me gjithë përpjekjet, nuk arritën ta realizojnë një gjë të tillë, kryesisht për arsye ekonomike, thonë dokumentet. Mbrojtja Kundërajrore dhe Aviacioni janë “takuar e ndarë” disa herë nga forma organizative, por bashkëpunimi i tyre ka qenë gjithnjë i pashkëputur. Në fillimet e saj, arma e Aviacionit ka qenë pjesë e Komandës së Mbrojtjes Kundërajrore, gjë që ka vazhduar deri në vitin 1974 për t’u bashkuar

përsëri në Forcat e Mbrojtjes Ajrore në vitin 1995. Komandanti i parë i Aviacionit ka qenë Edip Ohri, i cili e ka komanduar atë deri në vitin 1974, për të vazhduar më tej me komandantët e tjerë të Aviacionit ndër vite.

Mbrojtja Kundërajrore, Aviacioni Luftarak dhe repartet e Vëzhgimit të Hapësirës Ajrore pavarësisht nga format organizative të ndryshme në vite kanë qenë gjithnjë të lidhura e në bashkëpunim të ngushtë me njëra-tjetrën, por edhe me lidhje varësie e strukturore të ndryshme me njëra-tjetrën në vite.

Mbrojtja Kundërajrore e vendit ka si ditë të themelimit të saj 1 korrikun e vitit 1931, datë në të cilën doli akti ligjor “Mbi organizmin e Ushtrisë Kombëtare” dhe u sanksionua vendosja e tri baterive të para kundërajrore në vendin tonë në portet e Shëngjinit, Durrësit e Sarandës. Mbrojtja Kundërajrore pati një zhvillim të madh për kohën në vitet 60-70. Në vitet 1954-1955 ajo

u pajis me bateri KA-85mm e mjete radioteknike më të sofistikuara, ndërsa në vitet 1957-1958 u pajis me bateri 57 dhe 100mm. Në vitet 1959-969, në armatim futen edhe raketat e drejtuara, topat AKA-37mm, topat 57mm dhe 100mm me drejtim automatik, mitralozat 14,5mm me katër tyta, dhe me radarë të zbulimit të largët, të mesëm, të afërt. Regjimenti i Raketave të Drejtuara Kundërajrore, që konsiderohej si krenaria e kësaj arme është krijuar më 6 dhjetor të vitit 1968. Në vitet ‘70 kishte 22 regjimente të AKA-së, 18 batalione mitraljerë AKA, që llogarisnin rreth 6 gryka zjarri për çdo kilometër të frontit.

Kurse Forcat Ajrore si strukturë u krijuan në vitin 2000 sipas strukturës organizative të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë të parashikuara nga Kushtetuta, ku në Forcat Ajrore bënin pjesë, Regjimenti i Helikopterëve, Brigada Ajrore, Detashmenti Ajror, Bazat Ajrore Mbështetëse, Batalioni i Vëzhgimit Ajror, Batalioni Logjistik, Qendra e Shërbimit Meteorologjik, Qendra e Riparimit të Avionëve, Shkolla e Trupës e Forcave Ajrore dhe nënreparte ndihmëse. Të gjitha këto reparte në vite e kohë të ndryshme kanë qenë pjesë e Mbrojtjes Kundërajrore dhe të Aviacionit Luftarak.

Me ndryshimet dhe implementimin në strukturën e re në vitin 2007 edhe në Forcat Ajrore u bënë ndryshime me qëllim rritjen e profesionalizmit dhe arritjen e standardeve të kërkuara për anëtarësimin në NATO. Me ndryshimet e ndodhura në strukturë në vitin 2007 deri në fund të vitit 2009. Forcat Ajrore u ristrukturuan në nivel Brigadë Ajrore dhe repartet e saj ishin: Regjimenti i Helikopterëve Farkë, Batalioni i Mbrojtjes Ajrore Marikaj, Shërbimi Meteorologjik, Baza Ajrore Rinas, Baza Ajrore Kuçovë, ndërsa Shkolla e Trupës së Forcave Ajrore kaloi në varësi të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes. Me ndryshimet e bëra në TOP, në fillim vitin 2010 Forcat Ajrore u ristrukturuan sërish në nivel Force Ajrore. Me ristrukturimin e ri Regjimenti i Helikopterëve kaloi në Bazën Ajrore. Baza Ajrore Rinas kaloi në Detashment VIP, QOSA (Qendra Operacionale e Sovranitetit Ajror) në QKR (Qendra e Kontroll Raportimit), Detashmenti Provizor Marikaj disloketohet në Rinas dhe emërtohet Qendra e Vëzhgimit Ajror.



QPR

**QENDRA E PERSONEL REKRUTIMIT, DO TË REKRUTOJË
KANDIDATË PËR STUDIME NË SHKOLLAT E LARTA
USHTARAKE TË GREQISË, 3 (TRE) TË DREJTA STUDIUMI.
AFATI KOHOR PËR DORËZIMIN E DOKUMENTACIONIT ËSHTË
DERI, MË 12 KORRIK 2023.**

PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI MË POSHTË:

<https://www.mod.gov.al/images/njoftime2023/qpr/qershor/studime-greqi/NJOFTIM-per-Studime-ne-Greqi.pdf>

